

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE  
SHQIPTARE SHA – KESH**

**PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA**

**Më 31 dhjetor 2018**

**(me raportin e audituesve të pavarur bashkëlidhur)**

<b>RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR</b> .....	ii
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2018.....	1
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.....	3
Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.....	4
1. Entiteti raportues .....	5
2. Bazat e përgatitjes .....	6
3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.....	6
4. Politika të rëndësishme kontabël .....	9
5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut .....	25
6. Aktivet afatgjata materiale.....	34
7. Aktivet financiare të arkëtueshme.....	37
8. Inventarët.....	38
9. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera .....	39
10. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to.....	40
11. Kapitali.....	41
12. Huatë .....	42
13. Grante.....	44
14. Të pagueshme tregtare dhe të tjera .....	44
15. Të ardhurat.....	44
16. Të ardhura të tjera operative.....	45
17. Energji e blerë.....	45
18. Shpenzime personeli.....	45
19. Shpenzime të tjera.....	46
20. Shpenzime financiare neto.....	46
21. Tatimi mbi fitimin .....	46
22. Palët e lidhura.....	48
23. Angazhime dhe detyrime të mundshme .....	49
24. Ngjarje pas datës së raportimit.....	49

## KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

### Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	1 janar 2017 (riparaqitur)
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata materiale	6	84,198,494	84,475,168
Aktive afatgjata jomateriale		-	50
Aktive financiare të arkëtueshme	7	7,479,132	7,143,602
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>91,677,626</b>	<b>91,618,820</b>
Inventarët	8	2,014,941	2,224,314
Aktive financiare të arkëtueshme	7	11,127,138	9,830,314
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	61,415,924	55,450,008
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10	1,037,702	795,273
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>75,595,705</b>	<b>68,299,909</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>167,273,331</b>	<b>159,918,729</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	11	20,162,799	20,174,222
Kapitali i paregjistruar	11	(4,000)	(4,000)
Rezerva ligjore	11	2,643,824	2,657,219
Vlera e drejtë e huave	11	4,702,728	5,146,532
Rezerva të tjera	11	54,889,816	55,915,384
Humbje të mbartura		(7,973,620)	(15,618,570)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>74,421,547</b>	<b>68,270,787</b>
<b>Detyrime</b>			
Huatë	12	29,484,738	22,636,032
Grante	13	115,733	119,618
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>29,600,471</b>	<b>22,755,650</b>
Huatë	12	47,542,512	57,125,768
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	14	15,708,801	11,766,525
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>63,251,313</b>	<b>68,892,293</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>92,851,784</b>	<b>91,647,943</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>167,273,331</b>	<b>159,918,729</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara në faqet 1 deri në 50 u aprovuan për dorëzim nga drejtimi i KESH Sh.a më 08 maj 2020 dhe janë firmosur si në vijim nga:

Benet Beci  
Administrator

Fitnetë Kodra  
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike

Eftiola Teko  
Shef i Sektorit të Kontabilitetit

Shënimet shpjeguese në faqet 11 deri në 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.



## KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

### Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

	Shënime	2018	2017 (riparaqitur)
Të ardhura	15	16,377,111	7,289,888
Të ardhura të tjera operative	16	32,344	3,897,731
Materiale dhe të lëndë të konsumueshme të përdoura		(131,784)	(115,600)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>16,277,671</b>	<b>11,072,019</b>
Energji e blerë	17	(487,348)	(3,647,021)
Shpenzime personeli	18	(945,238)	(949,027)
Shpenzime amortizimi	6	(2,335,543)	(1,996,341)
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	5.2.1	(256,748)	(220,738)
Provigjone për çështje gjyqësore	6	(47,546)	(95,232)
Shpenzime të tjera	19	(1,737,503)	(1,764,541)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>(5,809,926)</b>	<b>(8,672,900)</b>
Të ardhura financiare	20	2,558,741	1,936,867
Shpenzime financiare	20	(2,466,783)	(2,716,756)
<b>Shpenzime financiare neto</b>		<b>91,958</b>	<b>(779,889)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>10,559,703</b>	<b>1,619,230</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21	(2,981,244)	(558,901)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>7,578,459</b>	<b>1,060,329</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
<b>Zëra që nuk janë riklasifikuar në fitim ose humbje</b>			
Rivlerësim i aktiveve afatgjata materiale, neto i patatuar	6	-	-
<b>Totali i të të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>7,578,459</b>	<b>1,060,329</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 6 deri ne 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH**

**Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

Shënime	Kontribute/ tërheqje të		Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Vlera e drejtë e huave	Humbje të mbartura	Totali
	Kapitali aksionar	paregjistruar a kapitali					
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>20,174,222</b>	<b>(4,000)</b>	<b>2,657,219</b>	<b>47,062,540</b>	<b>5,050,939</b>	<b>(17,830,816)</b>	<b>57,110,104</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	1,060,329	1,060,329
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	1,060,329	1,060,329
Transferime të reserves së rivlerësimit	-	-	-	(1,178,645)	-	1,151,917	(26,728)
Rregullime të rezervave	-	-	-	10,031,489	95,593	-	10,127,082
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>20,174,222</b>	<b>(4,000)</b>	<b>2,657,219</b>	<b>55,915,384</b>	<b>5,146,532</b>	<b>(15,618,570)</b>	<b>68,270,787</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	7,578,459	7,578,459
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	-	-	-	-	-	7,578,459	7,578,459
Transferime të reserves së rivlerësimit	-	-	-	(1,124,715)	-	1,124,715	-
Shtesë në rezervën e rivlerësimit	-	-	-	2,718	-	-	2,718
Rregullime në rezervën e sigurimit të KESH	-	-	-	1,920	-	11,475	13,395
Transferime të rezervave ligjore	-	-	(13,395)	-	-	-	(13,395)
Ujje e kapitalit aksionar	(11,423)	-	-	-	-	-	(11,423)
Rregullime të reserves së rivlerësimit	-	-	-	94,509	(443,804)	-	(349,295)
Rregullime të fitim/humbjes së mbartur	-	-	-	-	-	(1,069,699)	(1,069,699)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>20,162,799</b>	<b>(4,000)</b>	<b>2,643,824</b>	<b>54,889,816</b>	<b>4,702,728</b>	<b>(7,973,620)</b>	<b>74,421,547</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 6 deri ne 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara.

## KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA -KESH

### Pasqyra e Konsoliduar e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

	Shënim e	2018	2017 (riparaqitur )
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi para tatimit		10,559,703	1,619,230
<i>Rregullime për:</i>			
- Amortizimin	6	2,335,543	1,996,341
- Provigjonet për çështjet gjyqësore	24	47,546	95,232
- (Rimarrje) / humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	9	(8,630)	186,417
- Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të inventarit	8	260,380	3,559
- (Rimarrje) / humbje nga zhvlerësimi i mjeteve monetare	10	(84)	1,510
- Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	7	2,943	28,229
- Provigjone të tjera		2,140	1,023
- Të ardhurat nga subvencionet dhe grantet	17	(3,885)	(11,534)
- Të ardhurat nga interesat	21	(646,958)	(933,908)
- Shpenzimet për interesa	21	2,466,783	2,716,756
- Ndryshimin në vlerën e drejtë të huave	21		25,880
- Ndryshimin në fitim/humbje nga kursi i këmbimit	21	(1,911,783)	(1,002,959)
- Të ardhurat nga falja e penaliteteve tatimore	17	-	(3,783,144)
<i>Ndryshime në:</i>			
- Inventarë		(51,007)	(32,350)
- Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(5,610,009)	806,791
- Të pagueshme tregtare dhe të tjera		6,420,453	(1,608,205)
		<b>13,863,134</b>	<b>108,868</b>
Interes i paguar		(996,884)	(1,248,426)
Tatim mbi fitimin i paguar		(4,827,434)	(1,427,382)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet operative</b>		<b>8.038.816</b>	<b>(2,566,940)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(2,308,773)	(4,544,190)
Flukse nga huatë e dhëna palëve të treta, neto		(988,793)	1,457,734
Interesa të arkëtuara		1,558	41,483
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese</b>		<b>(3,296,008)</b>	<b>(3,044,973)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Të hyra nga huatë, neto		12,950,458	4,127,934
Pagesa për huatë		(1,004,530)	(889,132)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>11,945,928</b>	<b>3,238,802</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to</b>		<b>16,688,736</b>	<b>(2,373,111)</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar	10	(33,117,417)	(30,744,306)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor</b>	10	<b>(16,428,680)</b>	<b>(33,117,417)</b>

Shënimet shpjeguese në faqet 6 deri në 50 janë pjesë thelbësore e pasqyrave financiare të konsoliduara

## **1. Entiteti raportues**

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare – KESH sh.a dhe Shoqëritë e kontrolluara prej saj (“KESH” ose “Grupi”) është një shoqëri aksionare e themeluar në Republikën e Shqipërisë. Grupi u regjistrua më 31 dhjetor 1994 duke u bazuar në vendimin nr. 74 të Ministrisë së Financave, datë 2 nëntor 1995. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë zotëron plotësisht kapitalin aksionar të KESH-it më 31 dhjetor 2018.

Më 31 dhjetor 2018, Grupi zotëronte kapitalin aksionar të filialeve të “KESH Security SHRSF” sh.a (“KESH Security”) dhe “Termocentrali Vlorë” sh.a (“TEC Vlorë”). KESH Security u themelua më 7 Prill 2008 bazuar në vendimin nr. 14 të Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe është përfshirë në sigurimin e shërbimeve të ruajtjes për Grupin. Bazuar në vendimin nr. 15 datë 28 shtator 2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe në vendimin nr. 2 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, u vendos të fillohet me procedurat e likuidimit të KESH Security. Shoqëria e kontrolluar nuk është materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

TEC Vlorë u regjistrua bazuar në Vendimin e Gjykatës nr. 3862, më 18 qershor 2007 si një shoqëri tërësisht e kontrolluar nga KESH sh.a. Aktiviteti kryesor i TEC Vlorë është gjenerimi i elektricitetit nga termocentrale. Grupi përfundoi ndërtimin e termocentralit në vitin 2012 dhe që atëherë, nuk ka qenë në fazë prodhimi për shkak të një defekti në sistemin e ftohjes, i cili kërkon investime shtesë për riparim. Shoqëria mëmë mbulon shpenzimet operationale dhe ato të mirëmbajtjes së TEC Vlorë. Huaja e marrë për ndërtimin e TEC-it ripaguhet nga KESH.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015, datë 30 prill 2015 (“Ligji”), dhe në vendimin nr. 244 datë 30 mars 2016 të Këshillit të Ministrave, KESH ushtron rolin e prodhuesit të energjisë elektrike sipas të cilit Grupi duhet të furnizojë Furnizuesin Universal të Shërbimit (OSHEE) me një sasi të caktuar energjie për përmbushjen e kërkesës së konsumatorëve tariforë fundorë, me një çmim të rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”). Kjo sasi do të përcaktohet në kontratën e rregulluar midis palëve të miratuara nga ERE dhe do të përcaktohet bazuar në nivelin e prodhimit mesatar historik të KESH duke supozuar një shfrytëzim racional të kapaciteteve të tij prodhuese (shiko shënimin 5.2.2).

Akte të tjera nënligjore dhe rregullatore të nevojshme për zbatimin e Ligjit u miratua me Vendimin nr. 519, datë 13 korrik 2016, të Këshillit të Ministrave i cili miratoi modelin e ri të tregut të energjisë në mbështetje të Ligjit. Deri në nxjerrjen e këtij vendimi, KESH-i ka zbatuar rregullat e modelit të tregut që ishin në fuqi para daljes së, dhe sipas kërkesave të Ligjit (shiko shënimin 5.2.2).

Deri në vitin 2016, tarifa e shitjes së energjisë elektrike për KESH përcaktohej nga ERE, bazuar në një metodologji të aprovuar, ndërkohë duke nisur nga viti 2017 e në vijim, tarifa përcaktohet nga Ministria përgjegjëse (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë). Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2018, bazuar në vendimin nr. 3924/1 në 26 dhjetor 2017, MIE përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH sh.a. ndaj OSHEE sh.a. në masën 1.5 Lek/kWh, tarifën për shitjen e energjisë elektrike ndaj OST sh.a. në 1.5 Lek/kWh për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit dhe tarifën prej 158 Lek/MWh për shërbimet suportuese.

KESH aktualisht përbëhet nga KESH Security, TEC Vlorë, njësia e drejtorisë qendrore dhe nga tre njësi prodhuese hidroenergetikë të vendosura në kaskadën e lumit Drin. Shoqëria e ka adresën zyrtare në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Viktor Eftimiu, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2018 KESH ka 683 punonjës (31 dhjetor 2017: 706 punonjës).

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **(a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar (KIRFN) të BSNK.

Detaje për politikat kontabël të Grupit, janë përfshirë në Shënimin 4.

### **(b) Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjata materiale, të cilat janë paraqitur të rivlerësuar, dhe huave me mbajnë norma interesi më të ulëta se normat e tregut, të cilat janë matur fillimisht me vlerën e drejtë të tyre nëpërmjet fitimit dhe humbjes dhe më pas janë matur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

### **(c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, i cili është monedha funksionale e Grupit. Të gjitha shumat janë paraqitur duke u përafëruar në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

## **3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, Drejtimi ka përdorur gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Grupit dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi supozimet dhe pasiguritë në vlerësim që kanë rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2018 janë përfshirë në shënimet e mëposhtme:

- Shënimi 4.j dhe 6.ii: testi i zhvlerësimit: supozimet kryesore dhe pasiguritë në vlerësim për përcaktimin e shumave të rikuperueshme;
- Shënimi 6.i: matja e aktiveve jo-financiare me vlerën e drejtë;
- Shënimi 4.k dhe 5.2.1: politika e zhvlerësimit dhe politika e provigjonimit së aktiveve financiare;
- Shënimi 4.g dhe 24: njohja dhe matja e provigjoneve dhe detyrimeve të mundshme: supozimet kryesore mbi mundësinë dhe madhësinë e flukseve ekonomike dalëse;
- Shënimi 4.c dhe 8: vlerësimi i vlerës neto të realizueshme; dhe
- Shënimi 4.o, 15 dhe 22: njohja e aktiveve për tatime të shtyra: disponueshmëria e fitimit të tatueshëm në të ardhmen, ndaj të cilit mund të përdoren humbjet e mbartura tatimore.
- Shënimi 24: supozime dhe gjykime lidhur me detyrimet e kushtëzuara

### ***Matja e vlerës së drejtë***

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të Grupit kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Grupi ka angazhuar vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të konsiderueshme të vlerës së drejtë, duke përfshirë Nivelin 3 të vlerës së drejtë për aktivet jo-financiare. Menaxhimi vlerëson evidencën e marrë nga palët e treta për të mbështetur përfundimin se këto vlerësime përputhen me kërkesat e SNRF, duke përfshirë edhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilin vlerësime të tilla duhen klasifikuar. Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Grupi përdor gjykimin e tij për të zgjedhur një numër të ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë raportimi. Grupi përdor analizën e skontuar të flukseve të parasë për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk shiten në tregje aktive. Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Grupi përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur.



### **3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

#### ***Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)***

Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të dhënave të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

- Niveli 1: çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta apo identike.
- Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme ose drejtpërdrejt (p.sh. çmimet) ose në mënyrë indirekte (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për një aktiv ose detyrim.
- Niveli 3: të dhëna për aktivin ose detyrimin, të cilat bazohen në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna jo të vëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Grupi i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi. Informacione të mëtejshme për supozimet e bëra në matjen e vlerës së drejtë janë përfshirë në Shënimet 5.1 dhe 6.i.

#### **Rritja e konsiderueshme e rrezikut të kreditit**

Siç shpjegohet dhe më poshtë, humbjet e pritshme të kreditit maten si një provigjon i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore për instrumentet e Fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumente të Fazës 2 ose 3. Një instrument financiar lëviz në Fazën 2 kur rreziku i tij i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. SNRF 9 nuk e përcakton çfarë nënkupton një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kreditit. Për të vlerësuar nëse rreziku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Grupi merr parasysh informacion cilësor dhe sasior të arsyeshëm dhe të parashikuar.

Bazuar në përmirësimin ekonomik të OSHEE-së, dhe për faktin se është njësi e zotëruar nga shteti, me një mbështetje të madhe nga qeveria shqiptare, Grupi vlerësoi se rreziku i tyre është i ndërlidhur pozitivisht me rreziku e kreditit të shtetit shqiptar.

Përveç kësaj, duke konsideruar gjithashtu rolin e qeverisë shqiptare si garantor të OSHEE në kreditë e marra nga institucione financiare ndërkombëtare dhe rolin e saj mbikëqyrës në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri dhe të gjithë pjesëmarrësve në treg, ekziston mundësia e netimit ose fshirjes së balancave të papaguara midis pjesëmarrësve, duke përfshirë KESH, OSHEE dhe OST. Rrjedhimisht, ky faktor ul rrezikun e kreditit duke ndikuar dhe në klasifikimin në Fazën 1. Bazuar në vlerësimin e Drejtimit, për llogaritë e arkëtueshme me OSHEE sh.a dhe OST sh.a është aplikuar “Qasja e përgjithshme”.

Përveç kësaj, asnjë nga kriteret e përcaktuara në SNRF 9 nuk përmbushet kur vlerësohet rreziku i kreditit të OSHEE, prandaj është përdorur gjykimi profesional për të klasifikuar rrezikun e kreditit të OSHEE edhe OST në Fazën 1, duke matur humbjen e pritshme të kreditit në mënyrë individuale, duke përdorur humbjen e pritshme 12-mujore të rrezikut të kreditit. Edhe pse ka më shumë se 90 ditë me vonesë për disa shuma, ekziston një marrëveshje në fuqi me Shoqërinë që të gjitha këto shuma do të paguhën. Gjithashtu, bazuar në përvojën e saj historike, të gjitha të arkëtueshmet me OSHEE-në dhe OST-në janë rikuperuar dhe shkalla e humbjes ka qenë 0%. Është e rëndësishme të përmendet se nuk ka ngjarje aktuale/të pritura që kanë ndryshuar ose pritet të ndryshojnë rrezikun e kreditit të OSHEE-së krahasuar me vitet e mëparshme.

Sipas klasifikimit të rrezikut të kreditit të OSHEE dhe OST, (megjithëse ka një balancë të prapambetur që tejkalon periudhën prej 90 ditësh) ne kemi konsideruar të klasifikohet në Fazën 1 për arsyet e mëposhtme:

- a. OST dhe OSHEE janë entitete shtetërore dhe qeveria shqiptare vepron si garantor;
- b. Nuk është e mundur që OST të hyjë në falimentim.

Klasifikimi në Fazën 2 për OSHEE dhe OST do të ishte i mundur në rast se:

- a. Një institucion publik do të falimentonte.
- b. Do të pritej përkeqësim i konsiderueshëm në rezultatet operative të OSHEE / OST të tilla si:

### 3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

- Rënie e konsumit të përgjithshëm të energjisë në shkallë kombëtare;
  - Blerje e paparishikueshme e energjisë me kosto shtesë si pasojë e uljes së rezervave.
- c. Nëse performanca financiare e entiteteve do të përkeqësohej për shkak të faktorëve të tjerë jo të lidhur me kushtet atmosferike.

Klasifikimi në Fazën 3 do të ishte i aplikueshëm nëse do të kishte plane konkrete të dhënies me koncesion nga shteti, nëse do të kishin vështirësi financiare apo do të falimentonin.

#### **Llogaritja e provigjoneve**

Gjatë matjes së humbjes së pritshme të kreditit, Grupi përdor informacion të arsyeshëm dhe të parashikuar, i cili bazohet në supozimet për lëvizjet e ardhshme të faktorëve të ndryshëm nxitës ekonomikë dhe se si këto faktorë do të ndikojnë tek njëri-tjetri.

Humbja nga mos shlyerja është një vlerësim i humbjes që vjen nga mosgapagimi, duke u bazuar në diferencën midis fluksit monetar kontraktual që paguhet dhe atij që pritët të merret. Implementimi i “Qasjes së Thjeshtuar” është përdorur për aktivet financiare, llogaritë e arkëtueshme dhe mjetet monetare dhe ekuivalentet me to. Sipas Drejtimit, analiza e vjetërsisë nuk është kryer e ndarë në 1-30 ditë, 30-60 ditë, 60-90 ditë edhe më shumë se 90 ditë, prandaj janë identifikuar vetëm gjendjet që nuk janë paguar për më shumë se 365 ditë.

Në lidhje me aktivet financiare, këto balanca përfshijnë kreditë e dhëna drejt OST sh.a, OSHEE sh.a edhe EPCG. Prandaj, Drejtimi ka parë të arsyeshme të aplikojë një normë të humbjeje prej 74% për të gjitha balancat e papaguara mbi 365 ditë. Ndërkohë që duke u bazuar në një normë të humbjes së kreditit historik, për balancat që janë nën 365 ditë pa paguar është aplikuar një normë prej 0.17%.

E njëjta normë humbjeje (0.17%) është zbatuar për të gjitha grupet e llogarive të arkëtueshmeve, aktiveve financiare dhe mjete monetare dhe ekuivalente me to për matjen e provigjonit më 31 dhjetor 2017 dhe për periudhën e përfunduar më 31 dhjetor 2018.

Mundësia e mospagimit përbën një faktor kyç në matjen e humbjes së pritshme të kreditit. Mundësia e mospagimit është një vlerësim i mundshëm i mospagimit përgjatë një periudhë të caktuar kohore, llogaritja e të cilës përfshin të dhëna historike, supozime dhe pritshmëri për kushtet e ardhshme.

Tabela e mëposhtme prezanton analizën e sensitivitetit për normat e humbjes së pritshme të kreditit të llogarive të arkëtueshme, aktiveve financiare me vonesë më të ulët se 365 ditë, dhe mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to do të ishin 0.01% më të larta (ose ulëta) më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

Efekti në pozicionin financiar	2018		2017	
	LEK ‘000	(%)	LEK ‘000	(%)
Të arkëtueshme tregtare	5,762	(5,762)	5,215	(5,215)
Aktive financiare	1,889	(1,889)	1,711	(1,711)
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	104	(104)	80	(80)

#### **COVID-19**

Përhapja e shpejtë e virusit COVID-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe në mbarë botën mund të kërkojë rishikime në supozime dhe vlerësime. Këto rishikime mund të shkaktojnë rregullime të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, Drejtimi i pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura të ndikojnë në përcaktimin e vlerave kontabël për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera, huatë financiare, të arkëtueshmet tregtare dhe të pagueshme të tjera. Sidoqoftë, në këtë fazë Drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të sigurtë ndikimin pasi ngjarjet vazhdojnë të përshkallëzohen çdo ditë. Ndikimi afatgjatë mund të prekë kryesisht të ardhurat, flukset monetare dhe përfitueshmërinë. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, Grupi vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël**

Grupi ka aplikuar në mënyrë të qëndrueshme politikat e mëposhtme kontabël për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

##### **a. Bazat e konsolidimit**

###### *(i) Filialet*

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Grupi kontrollon një filial kur është i ekspozuar ose ka të drejtën për kthime të ndryshueshme nga përfshirja e tij në njësinë ekonomike dhe ka aftësinë për të ndikuar në ato kthime nëpërmjet fuqisë së tij mbi njësinë ekonomike. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira tek pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e mbarimit të tij.

###### *(ii) Transaksionet e eliminuara gjatë konsolidimit*

Balancat dhe transaksionet brenda grupit, dhe ndonjë shumë e porealizuar e të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet brenda grupit janë eliminuar.

Fitimet e porealizuara që vijnë nga transaksionet me investimet e mbajtura sipas metodës së kapitalit eliminohen deri në masën e interesit që Grupi ka tek investimi. Humbjet e porealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e porealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për zhvlerësim.

##### **b. Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën korresponduese funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerë të drejtë në monedhë të huaj konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni.

##### **c. Inventarët**

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën hyrje e parë, dalje e parë (FIFO) dhe përfshin shpenzimet për blerjen e inventarëve, koston e prodhimit apo të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë sjelljes së tyre në vendndodhjen dhe kushtet ekzistuese.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur koston e vlerësuar të përfundimit dhe shitjes.

##### **d. Aktivitet afatgjata jomateriale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale të blera nga Grupi janë paraqitur me kosto të pakësuar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit. Shpenzimet në vijim të aktiveve afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivitet specifike me të cilat lidhen. Të gjitha koston e tjera njihen si shpenzim në momentin që ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve afatgjata jomateriale. Jetëgjatësia e parashikuar është 5 vite.

##### **e. Aktivitet afatgjata materiale**

###### *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata materiale në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar janë përfshirë me vlerën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë në datën e rivlerësimit së cilës i zbritet zhvlerësimi i akumuluar dhe cdo humbje pasardhëse e akumuluar nga rënia e vlerës.

Rivlerësimet janë kryer me rregullsi të mjaftueshme, të tillë që vlerat kontabël nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga ato që do të përcaktoheshin duke përdorur vlerën e drejte në fund të cdo periudhe raportimi.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **e. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

Çdo tepricë nga rivlerësimi njihet në të Ardhurat e Tjera Gjithëpërfshirëse ('ATGJ') përveç se në rastin kur teprica e rivlerësimit anulon deficitin e mëparshëm të rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur në fitim ose humbje, rast në të cilin kreditimi deri në atë masë njihet në fitim ose humbje. Çdo deficit në rivlerësim njihet në fitim ose humbje, përveç se në rastin që anulon një tepricë të mëparshme të rivlerësimit të njëjtit aktiv, rast në të cilin debitimi deri në atë masë njihet në ATGJ. Prandaj, tepricat dhe rëniet në vlerë nuk mund të netohen edhe brenda të njëjtës klasë aktivesh. Rezerva e rivlerësimit përfshihet në rezerva të tjera (Shënimi 11.4) dhe transferohet në fitimet e mbartura përgjatë përdorimit të aktivit korrespondues.

Nëse pjesë të konsiderueshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë ato njihen si aktiv i ndarë më vete (komponentët kryesorë) të aktivit afatgjatë material.

##### *Njohja dhe matja (vazhdim)*

Ndërtimet në proces mbahen me kosto, pakësuar me humbjet e njohura nga zhvlerësimi (nëse ka) dhe klasifikohen në kategoritë e duhura të aktiveve afatgjata materiale kur përfundohen dhe janë të gatshme për përdorim. Kosto përfshin të gjitha shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me përftimin e aktivit. Këto shpenzime përfshijnë tarifatat profesionale, ndërsa për aktivet e kualifikuara kostot e huamarrjes të kapitalizuara në përputhje me politikat kontabël të Grupit.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material njihet në fitim ose humbje.

##### *Shpenzimet e mëpasshme*

Shpenzimet e mëpasshme të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohet vetëm nëse është e mundshme që benefitet e pritshme ekonomike të shoqëruara me shpenzimin do të rrjedhin drejt Grupit dhe kur fatura për mallrat merret së bashku me/ose pranimi provizor aprovohet.

##### *Amortizimi*

Amortizimi përllogaritet për të pakësuar shumat e rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale duke i zbritur vlerën e mbetur sipas metodës lineare të amortizimit përgjatë jetës së vlerësuar të dobishme, dhe njihet në fitim ose humbje.

Jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si në vijim:

- |                            |              |
|----------------------------|--------------|
| • Ndërtesa                 | 8 - 100 vite |
| • Makineri dhe pajisje     | 5 - 80 vite  |
| • Mjete transporti         | 5 - 15 vite  |
| • Mobilje dhe pajisje zyre | 2 - 4 vite   |

Toka dhe ndërtimet në proces nuk amortizohen.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

##### **f. Instrumentet financiarë**

##### *Aktivtë financiarë joderivative*

Grupi fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera, dhe depozitat në datën që ato krijohen. Të gjithë aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, kur Grupi bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Grupi çregjistron një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Grupit mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur Grupi transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivi financiar në një transaksion në të cilin gjithë rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar transferohen. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet apo mbahet nga Grupi, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Aktivtë dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **f. Instrumentet financiarë (vazhdim)**

*Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

*Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera (vazhdim)*

Grupi gjithmonë e mat provigjonin për llogaritë e arkëtueshme në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të përgjatë gjithë jetëgjatësisë. Humbjet e pritshme për llogaritë e arkëtueshme për llogariten duke përdorur një matricë provigjoni me referencë nga eksperiencia e kaluar e mosshlyerjes nga ana e klientit dhe nga një analizë e pozicionit aktual financiar të tij, e rregulluar për faktorë që janë specifike për klientin, kushtet ekonomike të përgjithshme të industrisë në të cilën klientët operojnë dhe një vlerësim i rrjedhës së parashikuar dhe aktuale të kushteve në datën e raportimit. Grupi ka njohur një normë provigjoni prej 74% kundrejt të gjitha llogarive të arkëtueshme me 2 vite vonesë, sepse eksperiencia historike ka treguar se këto llogari janë përgjithësisht të rekuperueshme në këtë periudhë.

Nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në teknikat e vlerësimit apo në supozime të rëndësishme gjatë periudhës aktuale të raportimit. Grupi njuh një fond provigjoni kur ka informacion që tregon se klienti është në vështirësi financiare dhe nuk ka një perspektivë realiste të rimëkëmbjes, p.sh. kur klienti është proces likuidimi ose ka hyrë në procedura të falimentimit, ose kur një llogari e arkëtueshme është mbi dy vjet e pashlyer, cilado që të ndodhë më herët.

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë mjetet monetare gjendje dhe depozitat me afat fillestar maturimi jo më të madh se tre muaj. Overdraftet bankare, që janë të ripagueshme sipas kërkesës dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të menaxhimit të mjeteve monetare të Grupit, përfshihen në mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në pasqyrën e flukseve monetare.

*Detyrimet financiare joderivative*

Grupi fillimisht i njuh detyrimet financiare në datën e tregtimit, kur Grupi bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Grupi e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e tij kontraktuale shlyhen ose anulohen apo përfundojnë.

Aktivitetet dhe detyrimet financiare paraqiten me vlerë neto në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat e tyre, dhe ka për qëllim ose të shlyejë shumën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Detyrimet financiare joderivative të Grupit janë si vijon: hua dhe llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Këto detyrime financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të lidhura direkt me transaksionin.

Për huatë e marra drejtpërdrejt nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit, norma e tregut përcaktohet duke u nisur nga perspektiva e bankave të zhvillimit dhe përgjithësisht është e barabartë me normën e kontratës, për shkak se bankat e zhvillimit përbëjnë tregun për Grupin.

Për fondet e financuara fillimisht nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit dhe më pas të nën-huazuara tek KESH nga Qeveria apo OSHEE dhe OST, norma e tregut është përcaktuar fillimisht duke iu referuar normave të ofruara nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit. Diferenca midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe vlerës nominale të huasë konsiderohet si kontribut nga aksionari dhe kontabilizohet si rezervë rivlerësimi në kapital.

Pas njohjes fillestare këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **g. Provigjonet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet specifike të detyrimit. Ndryshimi i skontimit për shkak të vlerës në kohë të parasë njihet si kosto financimi.

##### **h. Grantet**

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe që Grupi do të jetë në përputhje me kushtet që i janë bashkëngjitur atyre. Grantet që kompenzojnë shpenzimet e ndodhura të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje në të njëjtën periudhë në të cilën ndodhin shpenzimet. Grantet që kompenzojnë Grupin për koston e aktiveve, njihen në mënyrë sistematike në fitim ose humbje përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

##### **i. Kapitali aksionar dhe dividendët**

###### *Kapitali aksionar*

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

###### *Dividendët*

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Grupit njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit si detyrim në periudhën në të cilën aprovohen nga aksionari i Grupit.

##### **j. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësimin e tyre. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të pritura të parasë skontojnë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Me qëllim që të testohet zhvlerësimi, aktivitetet që nuk mund të testohen individualisht janë grupuar bashkë në grupin më të vogël të aktiveve që gjeneron flukse hyrëse të parave nga përdorimi i vazhdueshëm i aktiveve që janë kryesisht të pavarura nga flukset hyrëse të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve (njësia e gjenerimit të parasë ose "CGU").

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e CGU-së së tij tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet e njohura nga zhvlerësimi i CGU-ve shpërndahen duke pakësuar vlerat kontabël të aktiveve në njësi (grupin e njësive) në mënyrë përpjesëtimore.

Humbjet nga zhvlerësimi vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues që humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret vetëm deri në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar pasi të zbritej amortizimi, nëse nuk do të ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

##### **k. Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Modeli i zhvlerësimit në SNRF 9 bazohet në modelin e humbjeve të pritshme të kreditit ("ECL") dhe zëvendëson modelin e humbjeve të pësuar të SNK 39, duke rezultuar në njohjen e një provigjoni humbjesh përpara se të ndodhë humbja e kreditit. Sipas kësaj qasje, Grupi merr në konsideratë kushtet aktuale dhe informacionin e arsyeshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme gjatë vlerësimit të humbjeve të pritura të kreditit. SNRF 9 përcakton një "Qasje të Përgjithshme" për zhvlerësimin. Modeli ECL zbatohet për instrumentet financiare të regjistruara me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Parimi

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **k. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)**

udhëzues i modelit ECL është të pasqyrojë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit, ose përmirësimit, në cilësinë e kredisë së instrumenteve financiare.

Një aktiv financiar i mbajtur jo me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që ai është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse të dhëna objektive tregojnë se ka ndodhur një ngjarje e cila ka sjelle humbje pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka pasur efekt negativ mbi flukset monetare të parashikuara nga ai aktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme.

##### **Qasja e Përgjithshme**

Bazuar në këtë "Qasje të Përgjithshme", një provigjon për humbjet e pritshme të kreditit njihet për një instrument financiar nëse ka patur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kreditit (e matur duke përdorur probabilitetin jetëgjatë të falimentimit) që nga njohja fillestare e aktivitetit financiar. Nëse, në datën e raportimit, rreziku i kreditit për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, atëherë njihet një provigjon për humbjet e pritura 12 mujore të kreditit. Me fjalë të tjera, "Qasja e Përgjithshme" ka dy baza për të matur humbjet e pritura të kreditit:

###### **a) Humbjet e pritura 12-mujore;**

Humbja e pritur 12 mujore e kreditit është pjesa e humbjeve të pritura të kreditit gjatë gjithë jetës që paraqesin humbjet e pritshme të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

###### **b) Humbjet e pritura përgjatë gjithë jetëgjatësisë.**

Humbja e pritur gjatë gjithë jetëgjatësisë është humbja e pritur e kreditit që rezulton nga të gjitha ngjarjet e mundshme të falimentimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar.

Në përcaktimin e zhvlerësimit për modelin e thjeshtuar Grupi përdor trendin historik të probabilitetit të mospagimit, kohën e arkëtimit dhe shumën e humbjes së shkaktuar, korrigjuar sipas gjykimit të drejtuesve nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredihënies janë të tilla që humbjet aktuale ka të ngjarë të jenë më të mëdha ose më të vogla se sa sugjerohet nga tendencat historike.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe paraqiten në një llogari provigjoni që pakëson llogaritë e arkëtueshme. Kur një ngjarje e mëvonshme sjell zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, ky zvogëlim rimerret në fitim humbje.

##### **l. Njohja e të ardhurave**

Grupi është i përfshirë në shitjen e energjisë, si dhe kryerjen e shërbimeve të lidhura.

Të ardhurat nga shitja e elektricitetit tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ("OSHEE") njihen bazuar në sasinë e vërtetë të energjisë së përçar, matur në pikën e shpërndarjes dhe duke zbritur humbjet në transmetim.

Të ardhurat përfaqësojnë vlerën fikse ose të përcaktueshme të konsideratave në këmbim ose të arkëtueshme. Të ardhurat njihen me shumat e faturuara për klientët dhe përjashtojnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, zbritjet dhe skontot. Grupi njihet të ardhurat e tij gjatë një periudhe kohore pasi plotëson detyrimin e tij të performancës.

##### **m. Shpenzimet**

Në rrjedhën normale të biznesit, Grupi njihet shpenzime. Shpenzimet njihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve në bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

##### **n. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat e interesit nga fondet e investuara dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit si edhe fitimet ose humbjet nga huatë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes raportohen mbi bazë neto.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huatë dhe njihen në fitim ose humbje duke

përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **o. Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin e periudhës dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në fitim ose humbje përveç rasteve kur lidhen me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi fitimin e periudhës është tatimi i pritsëm për t'u paguar ose arkëtuar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, dhe që nuk ndikon fitimin ose humbjen kontabël dhe as atë tatimore.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën Grupi pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyer vlerën kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të jenë të zbatueshme ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi në datën e raportimit.

Aktivitetet dhe detyrimet e shtyra tatimore netohen mes tyre nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar detyrimet dhe aktivitetet tatimore të periudhës, dhe kur ato lidhen me tatime që vendosen nga i njëjti autoritet tatimor mbi të njëjtin subjekt tatimor, ose mbi subjekte të ndryshme tatimore, por që kanë për qëllim të shlyejnë detyrimet dhe aktivitetet tatimore të periudhës në baza neto, ose aktivitetet dhe pasivitetet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

Taksat e tjera që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi njihen në të njëjtën kohë si detyrimi për të paguar dividendin e lidhur me të.

Një aktivitet tatimor i shtyrë për humbje tatimore të papërdorura, njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme të tatueshme kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivitetet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

##### **p. Qiratë**

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave operative (pasi zbriten stimujt e pranuar nga qiradhënësi) njihen me metodën lineare në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë.

##### **q. Përfitimet e punonjësve**

*Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

*Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Grupi është i angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Grupi njuh kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontoen.

##### **r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara**

Standardet e reja dhe shtesat në standardet aktuale, si më poshtë, të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën aktuale të raportimit.

- SNRF 9 “Instrumentet Financiarë” (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018), SNRF 9 është zëvendësimi nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit i SNK 39 “Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja”. SNRF 9 përfshin kërkesat për njohjen dhe matjen, zhvlerësimin, çregjistrimin dhe kontabilitetin e përgjithshëm.



#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara (vazhdim)**

Klasifikimi dhe matja - SNRF 9 paraqet një qasje të re për klasifikimin e aktiveve financiarë, e cila është drejtuar nga karakteristikat pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv.

Kjo qasje e bazuar në parime, zëvendëson kërkesat ekzistuese të bazuara në rregullat sipas SNK 39. Modeli i ri rezulton gjithashtu në një model të vetëm zhvlerësimi që aplikohet në të gjitha instrumentet financiare.

Zhvlerësimi - SNRF 9 ka prezantuar një model të ri për humbjet e pritshme nga zhvlerësimi që do të kërkojë njohjen më në kohë të humbjeve të pritshme të kreditit (humbjet nga krediti). Në mënyrë të veçantë, standardi i ri kërkon që njësitë ekonomike të japin llogari për humbjet e pritshme të kreditit që nga momenti kur instrumentet financiare njihen për herë të parë dhe të njihen humbjet e pritshme të jetës së aktivit një bazë më të duhur.

Kontabiliteti i mbrojtjes - SNRF 9 paraqet një model të reformuar në mënyrë të konsiderueshme për kontabilitetin e mbrojtjes, ku është vendosur një rëndësi në aktivitetet e menaxhimit të rrezikut. Modeli i ri paraqet një rishikim të rëndësishëm të kontabilitetit të mbrojtjes që vendos në një linjë trajtimin kontabël me aktivitetet e menaxhimit të rrezikut.

Grupi ka zbatuar SNRF 9 në përputhje me dispozitat kalimtare të paraqitura në SNRF 9 në lidhje me Zhvlerësimin e Aktiveve Financiare më 1 Janar 2018 ku rregullimet kontabël duke aplikuar rregullimet ne retrospektivë për periudhën 31 dhjetor 2017.

Në lidhje me zhvlerësimin e aktiveve financiare, SNRF 9 prezanton një model të humbjeve të pritshme, në krahasim me SNK 39 që paraqet një model të humbjeve të ndodhura. Modeli i humbjeve të pritshme kërkon që Grupi të regjistrojë humbjet e pritshme të kreditit dhe ndryshimet në ato humbje të pritshme në çdo datë raportimi, për të pasqyruar ndryshimet në rrezikun e kreditit që nga njohja fillestare e aktiveve financiare. Me fjalë të tjera, nuk është më e nevojshme për një ngjarje krediti që të ketë ndodhur para se të njihen humbjet e kreditit. Specifikisht, SNRF 9 kërkon që Grupi të njohë një provigjon për humbjet e pritshme për:

- i. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera
- ii. Aktive financiare; dhe
- iii. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to.

Në veçanti, SNRF 9 kërkon që Grupi të matë provigjonin për humbjen e një instrumenti financiar, në shumë të barabartë me humbjen e pritshme përgjatë gjithë jetës së tij nëse rreziku i kreditit të atij instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare.

Megjithatë, nëse rreziku i kreditit të një instrumenti financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare, një Shoqëri duhet të matë provigjonin për humbjen e atij instrumenti financiar, në shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kreditit për 12 muaj.

SNRF 9 gjithashtu kërkon një Qasje të Thjeshtuar për matjen e provigjonit, në shumë të barabartë përgjatë gjithë jetës së llogarive të arkëtueshme dhe të tjera, si dhe aktiveve financiare.

Grupi ka zgjedhur të mos riparaqesë krahasimet që përcaktojnë nëse ka patur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit që nga njohja fillestare e instrumentave financiare ekzistues në datën e njohjes fillestare të SNRF 9 (1 janar 2018). Menaxhimi ka krahasuar rrezikun e kreditit të instrumentave financiare respektive në datën e njohjes së tyre fillestare të rrezikut të kreditit më 1 janar 2018.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR**  
**MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ka shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara (vazhdim)**

Rezultati i vlerësimit paraqitet si më poshtë:

Zëra ekzistues më 31 dhjetor 2017 që janë subjekt i dispozitave të zhvlerësimit nga SNRF 9	Shënime	Rreziku i kreditit nga 31 dhjetor 2017 deri më 31 dhjetor 2018	Provizioni shtesë i akumuluar më:	
			31 dhjetor. 2018	1 janar 2018
Të arkëtueshme financiare	8	Grupi zbaton “Qasjen e Thjeshtuar” dhe njëhënjë përgjatë gjithë jetës humbjen e pritshme të kreditit për këto aktive.	31,171	28,229
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	12	Të gjitha gjendjet e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre vlerësohen të kenë rrezik të ulët krediti në çdo datë raportimi meqë ato mbahen me institucione bankare me reputacion.	1,426	1,510

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera		31 dhjetor. 2018	1 janar 2018	
OSHEE		86,569	82,809	
OST	10	Të vlerësuara individualisht nëpërmjet “Qasjes së Përgjithshme”. Nuk ka patur rritje të konsiderueshme në rrezikun e mospagimit të kreditit bazë që nga njohja fillestare më 31 dhjetor 2017 deri më 31 dhjetor 2018. Grupi njëhënjë humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore për këto Shoqëri (palë e lidhur 100% në pronësi të Qeverisë, që ka gjithashtu marrëveshjeve për pagesën e balancave me vonesë).	7,293	1,658
Klientë të tjerë privatë		Grupi zbaton “Qasjen e Thjeshtuar” dhe njëhënjë përgjatë gjithë jetës, humbjen e pritshme të kreditit për këto aktive.	94,711	110,773

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR**  
**MË 31 DHJETOR 2018**

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara (vazhdim)**

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare sipas SNK 39 dhe SNRF 9.

	IAS 39		IFRS 9	
	Kategoria e matjes (huatë dhe llogaritë e arkëtueshme)	Vlera kontabël më 31 dhjetor 2017	Kategoria e matjes (kosto e amortizuar)	Vlera kontabël më 1 janar 2018
<b>Aktivet financiare</b>	-	-	-	-
Të arkëtueshme financiare	Kosto e amortizuar (Hua dhe të arkëtueshme)	20,038,455	Kosto e amortizuar	16,973,916
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	Kosto e amortizuar (Hua dhe të arkëtueshme)	796,783	Kosto e amortizuar	795,273
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	Kosto e amortizuar (Hua dhe të arkëtueshme)	52,792,409	Kosto e amortizuar	55,450,008
<b>Detyrimet financiare</b>				
Huatë	Vlerë e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	79,944,991	Kosto e amortizuar	79,761,800
Të pagueshme	Kosto e amortizuar (Hua dhe të arkëtueshme)	13,785,556	Kosto e amortizuar	11,766,525

- **SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"** dhe ndryshimet e mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). SNRF 15 specifikon se si dhe kur një raportues i SNRF-ve do të njohë të ardhurat, si dhe kërkon që subjekte të tilla t'u sigurojnë më tepër informacion përdoruesve të pasqyrave financiare. Standardi zëvendëson SNK 18 "Të Ardhurat", SNK 11 "Kontratat e ndërtimit" si dhe një numër interpretimesh lidhur me të ardhurat. Zbatimi i standardit është i detyrueshëm për të gjithë raportuesit sipas SNRF-ve dhe zbatohet për pothuajse të gjitha kontratat me klientët: përjashtimet kryesore janë qiratë, instrumentet financiare dhe kontratat e sigurimit. Parimi bazë i standardit të ri është që shoqëritë të njohin të ardhurat për të përshkruar transferimin e mallrave ose shërbimeve të klientët në shumën që reflektojnë shpërblimin (pagesën), për të cilën Grupi pret të ketë një të drejtë në këmbim të këtyre mallrave ose shërbimeve. Standardi i ri gjithashtu do të rezultojë në dhënien e shënimeve shpjeguese më të zgjeruara rreth të ardhurave, dhënien e udhëzimeve për transaksionet që nuk janë trajtuar më parë në mënyrë gjithëpërfshirëse (për shembull, të ardhurat nga shërbimet dhe modifikimet e kontratës) dhe përmirësimin e udhëzimeve për marrëveshjet me shumë elementë. Principet bazë të SNRF 15 përcaktohen në modelin me pesë hapa:

**Identifikimi i kontratës me klientin**

Një kontratë përkufizohet si një marrëveshje midis dy ose më shumë palëve që krijon të drejta dhe detyrime. Për të përcaktuar nëse një marrëveshje me një klient konsiderohet si një kontratë përbrënda objektit të SNRF 15, kriteret e mëposhtme duhet të vlerësohen dhe plotësohen në fillimin e marrëveshjes:

- Kontrata është miratuar nga palët, dhe palët janë angazhuar të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse (zbatueshmërinë);
- Grupi mund të identifikojë të drejtat e secilës palë në lidhje me mallrat ose shërbimet për t'u transferohen;
- Grupi mund të identifikojë kushtet e pagesës për mallrat ose shërbimet për t'u transferuar;

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara (vazhdim)**

- d) Kontrata ka thelb tregtar (d.m.th pritet që si rezultat i kontratës të ndryshojë frekuenca ose shuma e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare të Grupit ose rreziku i lidhur me to); dhe
- e) Është e mundur që Grupi do të arkëtojë shumën korresponduese për të cilën gëzon të drejtë nga transferimi i mallrave ose shërbimeve tek klienti.

##### **Identifikimi i detyrimeve për performancë**

Për të përcaktuar nëse një mall ose shërbim është i dallueshëm, Grupi konsideron nëse klienti mund të përfitojë nga malli ose shërbimi i marrë vetë ose së bashku me burime e tjera që janë në dispozicion të klientit. Grupi gjithashtu konsideron nëse premtimi i tij për të transferuar mallra ose shërbimit tek klienti identifikohet veçmas nga premtimet e tjera në kontratë.

Një premtim për të transferuar energji elektrike nën një marrëveshje shitje energjie përfaqëson një detyrim të performancës sepse është një premtim për të transferuar një seri mallrash të dallueshme të cilat janë në thelb të njëjta dhe që të transferohen tek klienti në të njëjtën mënyrë. Ky përfundim bazohet në faktorët vijues:

- a) një klient mund të përfitojë nga energjia elektrike veçmas (d.m.th., klienti mund të shesë energji elektrike, në menyrë të pavarur, në treg, etj.);
- b) premtimi për transferimin e energjisë elektrike është i identifikueshëm veçmas nga premtimet e tjera në kontratë.

Kushti i performancës për të furnizuar energji elektrike përmbushet me kalimin e kohës pasi klienti njëkohësisht merr dhe konsumon përfitimet e ofruara nga Grupi në masën e realizuar nga kjo e fundit. Çdo furnizim me energji elektrike në seri që Grupi premtion t'i transferojë klientit plotëson kriteret për të qenë një kusht i performancës që plotësohet me kalimin e kohës dhe e njëjta metodë do të përdoret për të matur përparimin e Grupit drejt përmbushjes së plotë të kushtit të performancës për transferimin e secilit furnizim të dallueshëm energjie elektrike në seri tek klienti.

##### **Përcaktimi i çmimit të transaksionit**

Çmimi i transaksionit është shuma korresponduese për të cilën pret të ketë të drejtë një njësi ekonomike në këmbim të transferimit tek klienti të mallrave apo shërbimeve të premtuara, duke përjashtuar shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta.

Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë përcaktimit të çmimit të transaksionit.

- (a) shumën korresponduese të ndryshueshme;
- (b) kufizimin në vlerësimet e shumës së ndryshueshme;
- (c) ekzistencën e një përbërësi financues të rëndësishëm në kontratë;
- (d) shumën korresponduese jo monetare; dhe
- (e) shumën korresponduese të pagueshme ndaj klientit.

Në kontratat ku vëllimi i energjisë për t'u dorëzuar është i ndryshueshëm dhe shuma korresponduese e premtuar përkufizohet si çmim për njësi energjie e dorëzuar, çmimi i transaksionit do të jetë i ndryshueshëm.

##### **Shpërndarja e çmimit të transaksionit**

Grupi zakonisht do të shpërndajë çmimin e transaksionit për çdo kusht të performancës në raport me çmimin specifik të shitjes për secilin mall ose shërbim të dallueshëm. Nëse një çmim specifik i shitjes nuk është i vrojtueshëm, Grupi do ta vlerësojë atë. Ndonjëherë, çmimi i transaksionit mund të përfshijë një skonto ose një shume korresponduese të ndryshueshme tek një pjesë specifike e kontratës. Kërkesat specifikojnë kur Grupi duhet të shpërndajë skonton ose shumën korresponduese të ndryshueshme tek një pjesë specifike të kontratës sesa për të gjitha kushtet e performancës në kontratë.

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

##### **r. Standarde dhe interpretime të reja ende të paimplementuara (vazhdim)**

###### **Njohja e të ardhurave kur kushtet e performancës janë plotësuar**

Një kusht i performancës është plotësuar kur një klient merr kontrollin e mallit ose shërbim të premtuar. Kontrolli transferohet ose në një moment kohor të caktuar ose përgjatë kohës.

Zbatimi i SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët nuk ka ndikim të rëndësishëm në njohjen dhe matjen e të ardhurave nga kontratat me klientët. Grupi zbaton qëllimin praktik sipas SNRF 15 ku të ardhurat nga energjia elektrike për kontratat e saj njihen në shumën e së cilës Grupi ka të drejtë të faturojë. Prandaj, aplikimi i SNRF 15 nuk ka asnjë ndikim në pozicionin financiar ose performancën e Grupit.

- ***Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa të bazuar në aksione"*** - Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- ***Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e sigurimit"*** - Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e sigurimit (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentet Financiare" aplikohet herën e parë).
- ***Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28*** për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- ***Ndryshime në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"*** – Transferimet e Aktiveve Afatgjata Materiale (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2018).
- ***Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"*** rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim të shmangies së mospërputhjeve dhe qartësim të formulimit (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2019).
- ***IFRIC 22 "Transaksionet në valutë dhe Konsiderata për Avancat"*** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Adoptimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të konsoliduara.

**Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqide nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri janë publikuar, por ende nuk janë efektive:

- ***SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"*** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- ***Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"*** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- ***Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"*** - Negative Compensation Prepayment Characteristics (effective for annual periods beginning on or after 1 January 2019).
- ***Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduar" dhe SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"*** - Shitja ose kontributi i aktiveve midis një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar deri në projektin kërkimor metoda e kapitalit është përfunduar).

#### **4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

- *Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"* - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020).
- *Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"* - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- *Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"* - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019).
- *Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"* që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- *Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- *KIFRN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat"* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi. Shoqëria parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara Shoqërisë në periudhën e zbatimit fillestar.

#### **s. Korrigjimi i gabimeve**

Gabimet mund të shfaqen në njohjen, matjen, prezantimin ose paraqitjen e zërave të pasqyrave financiare. Paraqitjet e gabuara materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë materiale nëse ato, individualisht ose të grupuara, mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që përdoruesit marrin bazuar në pasqyrat financiare të konsoliduara. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e konstatimit të gabuar ose të gjykimit të gabuar për shkak të rrethanave. Madhësia ose natyra e zërit financiar, ose një kombinim i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara, janë identifikuar konstatime të gabuara materiale që kanë çuar në një opinion auditimi me rezervë, i cili ka identifikuar gabime në lidhje me disa nga pikat e detajuara më poshtë. Grupi e konsideroi jopraktike për të përcaktuar kohën e këtyre gabimeve duke marrë parasysh ndryshimet në pasqyrat financiare të filialeve. Grupi korrigjoi këto gabime materiale vitin e kaluar në mënyrë retrospektive në grupin e parë të pasqyrave të pasqyruara financiare të konsoliduara, duke rivendosur gjendjen hapëse së aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto për vitin më të hershëm praktik për gabimet e identifikueshme. Gjatë vitit 2018, Drejtimi i Grupit ka ndërmarrë një iniciativë për të rregulluar pasqyrat financiare të konsoliduara në lidhje me gjetjet në opinionin e auditimit për vitin 2017. Si rezultat, pasqyrat financiare të konsoliduara janë riparaqitur duke reflektuar efektet siç tregohen në faqen vijuese:

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGJUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**s. Korrigjimi i gabimeve (vazhdim)**

**Pasqyra e pozicionit financiar**

Shënime	Më 31 dhjetor 2017 (raportuar më parë)	Rregullime	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	Më 31 dhjetor 2016 (raportuar më parë)	Rregullime	Më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)	
<b>Aktive</b>							
Aktive afatgjata materiale	A	96,340,744	(11,865,576)	84,475,168	94,594,540	(22,475,822)	72,118,718
Aktive afatgjata jomateriale		50	-	50	52	-	52
Aktive financiare të arktuëshme	B	12,690,077	(5,546,475)	7,143,602	14,877,806	(7,151,944)	7,725,862
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>109,030,871</b>	<b>(17,412,052)</b>	<b>91,618,820</b>	<b>109,472,398</b>	<b>(29,627,767)</b>	<b>79,844,632</b>
Inventarët	C	2,521,038	(296,724)	2,224,314	2,488,688	(293,165)	2,195,523
Aktive financiare të arktuëshme	B	7,348,378	2,481,936	9,830,314	6,131,430	3,619,955	9,751,385
Të arktuëshme tregtare dhe të tjera	D	52,792,409	2,657,599	55,450,008	53,599,200	2,819,092	56,418,292
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	E	796,783	(1,510)	795,273	805,336	-	805,336
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>63,458,608</b>	<b>4,841,301</b>	<b>68,299,909</b>	<b>63,024,654</b>	<b>6,145,882</b>	<b>69,170,536</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>172,489,479</b>	<b>(12,570,750)</b>	<b>159,918,730</b>	<b>172,497,052</b>	<b>(23,481,885)</b>	<b>149,015,168</b>
<b>Kapitali</b>							
Kapitali aksionar		20,174,222	-	20,174,222	20,174,222	-	20,174,222
Kapitali i paregjistruar		(4,000)	-	(4,000)	(4,000)	-	(4,000)
Rezerva ligjore		2,657,219	-	2,657,219	2,657,219	-	2,657,219
Vlera e drejtë e huave	F	-	5,146,532	5,146,532	-	5,050,939	5,050,939
Rezerva të tjera		68,893,553	(12,978,170)	55,915,383	70,072,200	(23,009,661)	47,062,539
Humbje të mbartura		(14,373,523)	(1,245,046)	(15,618,569)	(15,472,712)	(2,358,104)	(17,830,816)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>77,347,471</b>	<b>(9,076,684)</b>	<b>68,270,787</b>	<b>77,426,929</b>	<b>(20,316,826)</b>	<b>57,110,103</b>

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**s. Korrigjimi i gabimeve (vazhdim)**

**Pasqyra e pozicionit financiar (vazhdim)**

	Shënime	Më 31 dhjetor 2017 (raportuar më parë)	Rregullime	Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	Më 31 dhjetor 2016 (raportuar më parë)	Rregullime	Më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)
<b>Detyrime</b>							
Huatë	<b>G</b>	28,532,506	(5,896,474)	22,636,032	30,481,251	-	30,481,251
Grante		119,618	-	119,618	131,152	-	131,152
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	<b>H</b>	810,147	(810,147)	-	810,146	(810,146)	-
Detyrime të shtyra tatimore	<b>I</b>	481,696	(481,696)	-	507,576	(507,576)	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>29,943,967</b>	<b>(7,188,317)</b>	<b>22,755,650</b>	<b>31,930,125</b>	<b>(1,317,722)</b>	<b>30,612,403</b>
Huatë	<b>G</b>	51,412,485	5,713,283	57,125,768	45,106,495	(750,128)	44,356,367
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	<b>H</b>	13,785,556	(2,019,031)	11,766,525	18,033,503	(1,097,208)	16,936,295
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>65,198,041</b>	<b>3,694,252</b>	<b>68,892,293</b>	<b>63,139,998</b>	<b>(1,847,336)</b>	<b>61,292,662</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>95,142,008</b>	<b>(3,494,066)</b>	<b>91,647,942</b>	<b>95,070,123</b>	<b>(3,165,058)</b>	<b>91,905,065</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>172,489,479</b>	<b>(12,570,750)</b>	<b>159,918,730</b>	<b>172,497,052</b>	<b>(23,481,885)</b>	<b>149,015,168</b>

**Shënime:**

**A** – Rregullimet e aktiveve afatgjata materiale më 2017 dhe 2016 kanë të bëjnë me testin e zhvlerësimit të aktiveve të HEC Fierza, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejes.  
**B** – Rregullimet e aktiveve financiare të arkëtueshme kanë të bëjnë me huatë ndaj OSHEE, OST dhe EPCG të matura me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me koston e amortizuar në përputhje me SNRF9.

**C** – Grupi ka kryer një analizë të vjetërsisë së inventarit të ngadaltë dhe identifikoi inventarët e dëmtuar. Për më tepër, Grupi vlerësoi vlerën neto të realizueshme duke përdorur çmimet e tregut për artikujt me vlerën më të lartë mbartëse. Rreth 77% e provigjionit të inventarit lidhet me inventarin e Koman. Për më tepër, Grupi përlogariti provigjion për zhvlerësimin e lëndëve djegëse, ku pjesa më e madhe lidheshin me inventarin e naftës në Tec Vlorë.



*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**s. Korrigjimi i gabimeve (vazhdim)**

**Pasqyra e pozicionit financiar (vazhdim) Shënime (vazhdim):**

**D** – Rregullimi i të arkëtueshmeve tregtare ka të bëjë me ndryshimin e rregullimeve të vitit të kaluar që rrjedhin nga vlera e drejtë e huave të dhëna dhe përfshin gjithashtu zhvlerësimin sipas SNRF 9.

**E** – Ky rregullim ka të bëjë me matjen e zhvlerësimit të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to në përputhje me SNRF 9.

**F** – Rregulli i vlerës së drejtë të rezervës së huave lidhet me matjen fillestare të huave të Grupit me norma interesi më të ulëta se tregu, në përputhje me SNRF 13 Matja e Vlerës së Drejtë.

**G** – Rregullimi paraqet ndryshimin e detyrimit tatimor të shtyrë në lidhje me rregullimin e vlerës së drejtë të llogaritur më pare nga Grupi.

**H** – Rregullimet e huave lidhen me matjen e vlerës së drejtë dhe koston së amortizuar në përputhje me SNRF 9.

**I** – Rregullimet ,mbi të pagueshmet tregtare dhe të tjera përfshijnë provigjone për çështje ligjore dhe fshirjen e gjendjeve të të pagueshmeve tregtare që nuk ekzistojnë.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**s. Korrigjimi i gabimeve (vazhdim)**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (raportuar më parë)	Rregullime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (raportuar më parë)	Rregullime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 (riparaqitur)
Të ardhura	7,289,888	-	7,289,888	16,521,118	-	16,521,118
Të ardhura të tjera operative	3,923,611	(25,880)	3,897,731	752,774	(127,534)	625,240
Materialle dhe të lëndë të konsumueshme të përdoura	(115,600)	-	(115,600)	(120,392)	-	(120,392)
<b>Gross income</b>	<b>11,097,899</b>	<b>(25,880)</b>	<b>11,072,019</b>	<b>17,153,500</b>	<b>(127,534)</b>	<b>17,025,966</b>
Energji e blerë	(3,647,021)	-	(3,647,021)	(8,279,508)	-	(8,279,508)
Shpenzime personeli	(949,027)	-	(949,027)	(1,040,654)	-	(1,040,654)
Amortizimi	(2,575,095)	578,754	(1,996,341)	(2,446,125)	533,839	(1,912,286)
Humbje nga zhvlerësimi	-	(220,738)	(220,738)	(330,313)	25,160	(305,153)
Provizione për çështje ligjore	(1,043,003)	947,771	(95,232)	-	(31,886)	(31,886)
Shpenzime të tjera	(1,764,541)	-	(1,764,541)	(892,763)	-	(892,763)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>(9,978,687)</b>	<b>1,305,787</b>	<b>(8,672,900)</b>	<b>(12,989,363)</b>	<b>527,113</b>	<b>(12,462,250)</b>
Të ardhura financiare	1,454,213	482,654	1,936,867	439,301	379,845	819,146
Shpenzime financiare	(2,067,252)	(649,504)	(2,716,756)	(2,816,621)	66,404	(2,750,217)
<b>Shpenzime financiare, neto</b>	<b>(613,039)</b>	<b>(166,850)</b>	<b>(779,889)</b>	<b>(2,377,320)</b>	<b>446,249</b>	<b>(1,931,071)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>506,173</b>	<b>1,113,057</b>	<b>1,619,230</b>	<b>1,786,817</b>	<b>845,828</b>	<b>2,632,645</b>
Tatimi mbi fitimin	(558,901)	-	(558,901)	(627,478)	-	(627,478)
<b>Fitimi neto për vitin</b>	<b>(52,728)</b>	<b>1,113,057</b>	<b>1,060,329</b>	<b>1,159,339</b>	<b>845,828</b>	<b>2,005,167</b>

**4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**s. Korrigjimi i gabimeve (vazhdim) Shënime**

**J** – Rregullimi i të ardhurave të tjera operative ka të bëjë me ndryshimet në periudhat e mëparshme.

**K** – Rregullimi i amortizimit vjen nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale.

**L** – Humbja nga zhvlerësimi përfshin zhvlerësimin e inventarit, të arkëtueshmeve tregtare dhe mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to.

**M** – Ky rregullim ka të bëjë me provigjionin e çështjeve gjyësore që njihen për secilin vit përkatës.

**N** – Rregullimet e të ardhurave / shpenzimeve financiare kanë të bëjnë me matjen e vlerës së drejtë me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, i cili rillogarit shpenzimet e interesave të huave. Për më tepër, rregullimet kanë të bëjnë me fitimet / humbjet nga kursi I këmbimit valutor të vlerës së drejtë të huave dhe të arkëtueshmeve financiare.

**5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut**

**5.1 Klasifikimet kontabël dhe vlera e drejtë**

Grupi nuk ka paraqitur vlerat e drejta të aktiveve financiare të tilla si mjetet monetare dhe ekuivalentet me to, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet tregtare, sepse vlera e tyre kontabël është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

**5.1.1 Instrumentet financiare që maten me vlerë të drejtë**

Grupi është palë e huave afatgjata me norma interesi më të ulëta se normat e tregut të cilat maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes dhe drejtimi ka kryer analiza për të përcaktuar vlerën e drejtë të këtyre borxheve. Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të huave afatshkurtra dhe afatgjata më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017 (riparaqitur)	
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)	Vlera kontabël	Vlera e drejtë (niveli 3)
Huatë afatgjata (Shënimi 12)	29,484,738	22,435,776	22,636,032	13,109,606
Huatë afatshkurtra (Shënimi 12)	47,542,512	36,176,450	57,125,768	33,084,257

Vlera e drejtë është vlerësuar si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të huave të ngjashme në datën e raportimit. Normat e interesit të përdorura për të skontuar flukset e ardhshme të huave/disbursimeve të marra gjatë 2018, variojnë nga 0.73% në 1% (njësoj për 2017: 0.73 % në 1%), ndërsa për sa i përket huave/disbursimeve të lëshuara në vitin e mëparshëm, normat e interesit të tregut variojnë nga 0.73% në 13.39% për një hua të marrë nga Japonia në JPN. Të gjithë normat e interesit të tregut, të përdorura për skonimin e flukseve të ardhshme të parasë janë përcaktuar duke përdorur normat e interesit të ofruara në treg nga bankat e zhvillimit.

Normat e tregut në datat e raportimit që janë përdorur në llogaritje, janë përcaktuar duke u bazuar në normat e ofruara nga bankat e zhvillimit. Drejtimi arriti në përfundimin se nuk ka të dhëna tregu të publikuara që mund të përdoren në përcaktimin e vlerave të drejta të duhura të huave afatgjata pa bërë rregullime të rëndësishme. Një sërë rreziqesh dhe rrethanash ndikojnë në përcaktimin e vlerave të drejta të këtyre instrumenteve financiare, duke përfshirë shumën e instrumentit financiar, afatin e maturimit, vlerësimin kreditor, llojin e interesit, monedhën, qëllimin e huasë, garancitë, mjedisin ekonomik në të cilin palët në instrumentet financiare veprojnë, dhe rrezikun vetjak të mosperformancës.

Për shkak të mungesës së të dhënave të vrojtueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nga tregu në lidhje me rreziqet dhe rrethanat e këtyre instrumenteve financiarë, vlerat e drejta të paraqitura më lart mund të konsiderohen vetëm si përafrim i arsyeshëm i vlerave të drejta dhe përmbushin kriteret për klasifikimin në nivelin e tretë në hierarkinë e vlerës së drejtë. Ndonëse Grupi konsideron se vlerat e drejta të vlerësuar janë të sakta, përdorimi i metodologjive dhe supozimeve të ndryshme mund të rezultojë në vlera të drejta të ndryshme.

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

## 5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

### 5.1 Klasifikimet kontabël dhe vlera e drejtë (vazhdim)

#### 5.1.1 Instrumentet financiare që maten me vlerë të drejtë (vazhdim)

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to, e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera dhe e të pagueshmeve përafrohet me vlerën e tyre kontabël duke qenë se janë instrument afatshkurtër pa interes.

Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve financiare afatgjata është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Vlera e drejtë është përcaktuar si vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

### 5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar

Grupi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme që vijnë prej aktiveve financiare:

- rreziku i kreditit;
- rreziku i tregut; dhe
- rreziku i likuiditetit.

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Grupit kryhet në raport me rreziqet financiare (të huasë, tregut, monedhës, likuiditetit dhe normës së interesit). Objektivi kryesor i funksionit të menaxhimit të rrezikut financiar është të vendosë limite rreziku, dhe më tej të sigurohet se ekspozimi ndaj rreziqeve mbahet brenda këtyre limiteve. Funksionet e rrezikut operacional dhe ligjor janë parashikuar të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar rreziqet operacionale dhe ligjore.

#### *Zhvillimet aktuale*

Drejtimi i Grupit kryen monitorime të rregullta mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve si edhe të zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare. Bazuar në këtë, drejtimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe kërkon të zbatojë masat e duhura në lidhje me rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut (kryesisht çmimit të energjisë dhe normës së interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke limituar kështu efektet e mundshme negative të pasigurive të jashtme. Për më tepër, Grupi është financiar nga bankat ndërkombëtare të zhvillimit apo nën-huazuar nga Qeveria ose palët e lidhura. Në këtë mënyrë, Grupi i përgjigjet sfidave të mjedisit të tregut duke ruajtur një kapital të qëndrueshëm.

#### 5.2.1 Rreziku i kreditit

Grupi ekspozohet ndaj rrezikut të kreditit, i cili është rreziku që njëra nga palët në një aktiv financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i Grupit ndaj rrezikut të kreditit lind për shkak të arkëtueshmeve financiare, tregtare dhe të tjera.

Maksimumi i ekspozimit të Grupit ndaj rrezikut të kreditit për kategori të aktiveve financiare dhe për kundërparti është si vijon:

	<b>2018</b>			
	<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>Të arkëtueshme nga klientë dhe të tjerë</b>	<b>Të arkëtueshme financiare</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare në banka dhe në tranzit (Shënimi 10)	1,037,702	-	-	1,037,702
OSHEE (kontrolluar nga shteti)	-	52,379,531	10,270,218	62,649,749
OST (kontrolluar nga shteti)	-	4,412,776	8,137,940	12,550,716
Punonjës	-	-	10,715	10,715
Entitete të tjera	-	4,623,617	187,397	4,811,014
<b>Totali i ekspozimit maksimal ndaj rrezikut të kredisë</b>	<b>1,037,702</b>	<b>61,415,924</b>	<b>18,606,270</b>	<b>81,059,896</b>

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR**  
**MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

**5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.2.1 Rreziku i kreditit (vazhdim)**

	2017 (riparaqitur)			Totali
	Mjete monetare dhe ekuivalente me to	Të arkëtueshme nga klientë dhe të tjerë	Të arkëtueshme financiare	
Mjete monetare në banka dhe në tranzit (Shënimi 10)	795,273	-	-	795,273
OSHEE (kontrolluar nga shteti)	-	50,104,336	8,353,962	58,458,298
OST (kontrolluar nga shteti)	-	1,003,154	8,295,595	9,298,749
Punonjës	-	-	10,715	10,715
Entitete të tjera	-	4,342,518	313,645	4,656,163
<b>Totali i ekspozimit maksimal ndaj rrezikut të kredisë</b>	<b>795,273</b>	<b>55,450,008</b>	<b>16,973,916</b>	<b>73,219,197</b>

*Menaxhimi i rrezikut të kreditimit*

Grupi ekspozohet ndaj rrezikut të kreditit në aktivitetet e tij të përditshme sepse mundet që kundërpartia e tij të dështojë në plotësimin e detyrimeve financiare. Rreziku i kreditit që krijohet nga të arkëtueshmet financiare të lidhur me hua të marra hua nga Grupi nga institucione të ndryshme (shënimi 7) menaxhohen dhe monitorohen mbi bazën e kontratave të nën-huave me përfituesit e projekteve të financuar me këto fonde. Këto projekte përfshijnë kushte dhe angazhime kapitale që ndihmojnë Grupin në monitorimin dhe minimizimin e rrezikut të kreditit. Këto angazhime analizohen dhe monitorohen në mënyrë të rregullt si kërkohet nga kontrata origjinale e kredisë.

*Përqendrimi i rrezikut të kreditit*

Grupi ekspozohet ndaj përqendrimit të rrezikut të kreditit. Drejtimi monitoron përqendrimin e rrezikut të kreditit por përballet me vështirësi në aplikimin e praktikave më të mira të politikave të menaxhimit përkundrejt ekspozimit të Grupit ndaj këtij rreziku për shkak të mungesës së diversifikimit të portofolit të klientëve. Në këto kushte, masat e diversifikimit janë të vështira të zbatohen dhe OSHEE përfaqëson përqendrimin kryesor.

Më 31 dhjetor 2018, balancat e arkëtueshme nga OSHEE përfaqësojnë 77.3% të ekspozimit maksimal total ndaj rrezikut të kreditit (2017: 79.8%).

*Zhvlerësimi*

Për më tepër, bazuar në një marrëveshje huaje të Qeverisë Shqiptare me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BIRZH) në 2014, OSHEE hapi një Llogari të Ngurtësimit të Ardhurave me një institucion financiar për të depozituar të ardhurat mujore për të paguar kostot e blerjes së energjisë në përputhje me një plan pagese të përcaktuar. Ndërkohë që pagesa minimale mujore përcaktohet në këtë plan pagese, OSHEE ka detyrimin t'i paguajë plotësisht shumat me vonesë Grupit.

Pasiguria më e madhe në vlerësimin e të arkëtueshmeve është koha kur do të paguhet të arkëtueshmet e vjetra më shumë se një vit nga OSHEE. Drejtimi konsideron se kjo varet kryesisht nga përfshirja e kërkuar e Qeverisë Shqiptare në cilësinë e zotëruesit të kontrollit mbi KESH dhe OSHEE. Në datën e raportimit, drejtimi beson se ka tregues se qeveria shqiptare parashikon veprime apo masa që adresojnë zgjidhjen e këtyre transaksioneve midis shoqërive. Si pjesë e marrëveshjes së huamarrjes që KESH ka nënshkruar me BIRZH në 2016, të garantuar edhe nga qeveria, njëri nga kushtet për disbursimin e huasë është arritja e një marrëveshjeje ndërmjet KESH dhe OSHEE për një skedul formal për shlyerjen e të arkëtueshmeve në vonesë.

Në 20 prill 2018, Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në përputhje me paragrafin 9.01 të Kushteve dhe Termave të Përgjithshme të Marrëveshjes së Kredisë dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin nr. 125/2016 "Për Projektin Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH", informoi KESH sh.a. për bërjen efektive të kredisë së dhënë në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke filluar nga data e marrjes së informacionit. Bazuar në kushtet e marrëveshjes së mësipërme,

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

paragrafi 2.02 (g), duke e bërë efektive marrëveshjen e njoftuar u disbursua kësti i parë prej 118 milionë Euro. Ky këst mbulon disa nga overdraftet që KESH sh.a ka marrë në bankat tregtare.

## 5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

### 5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### 5.2.1 Rreziku i kreditit (vazhdim)

##### Zhvlerësimi (vazhdim)

Sipas dispozitave të marrveshjes së mësipërme, paragrafi 2.02 (g) cilëson se bërja efektive e marrëveshjes nënkupton nisjen e procesit për disbursimin e këstit të parë prej 118 milionë Euro. Ky këst do të ristrukturojë strukturën aktuale të overdraftit që KESH sh.a. ka me bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, duke i ripaguar ato plotësisht.

Grupi beson se të dhënat e disponueshme vazhdojnë të tregojnë se ekspozimi i tij ndaj OSHEE nuk është zhvlerësuar më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Të arkëtueshmet për të cilat Grupi vendos se do të jetë e pamundur që të arkëtohen sipas kushteve kontraktuale të arkëtimit zhvlerësohen.

Tabela në vijim prezanton profilin e rrezikut të llogarive të arkëtueshme dhe të tjera bazuar në matricën e provigjonimit të Grupit. Duke qenë se eksperiencia historike e humbjes për Grupit nuk tregon modele humbjeje të konsiderueshme për segmente të ndryshme të klientëve, provigjoni që bazohet në statusin me vonesë nuk bën një dallim midis bazës së ndryshme të klientëve të Grupit për entitetet private. Në lidhje me gjendjet e OSHEE sh.a dhe OST sh.a vlerësimi ka qenë individual.

#### Të arkëtueshmet tregtare duke përjashtuar OSHEE dhe OST

##### Më 31 dhjetor 2018

	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
<b>Përcaktimi i humbjes së pritur</b>		
Balancat e papaguara në datën e raportimit	205,901	-
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	0.02%	-
Provigjoni i humbjes së pritshme të kreditit	47	-

#### Të arkëtueshmet tregtare duke përjashtuar OSHEE dhe OST më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)

	Më pak se 365 ditë me vonesë	Më shumë se 365 ditë me vonesë
<b>Përcaktimi i humbjes së pritur</b>		
Balancat e papaguara në datën e raportimit	44,278	-
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	0.02%	-
Provigjoni i humbjes së pritshme të kreditit	102	-

Llogaritë e arkëtueshme nga OSHEE dhe OST më 31 dhjetor 2018

	Monedha	Vlerësimi i Moody's*	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme <sup>(12 muaj)</sup> në monedhë vendase
OSHEE	Lek	B2	Faza 1	52,446,100	86,569
OST	Lek	B2	Faza 1	4,420,069	7,293
<b>Totali</b>				<b>56,866,169</b>	<b>93,862</b>

#### Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)

	Monedha	Vlerësimi i Moody's*	Faza e klasifikimit	EAD në monedhë vendase	Humbja e prishme <sup>(12 muaj)</sup> në monedhë vendase
OSHEE	Lek	B2	Faza 1	50,187,145	82,809
OST	Lek	B2	Faza 1	1,004,812	1,658
<b>Totali</b>				<b>51,191,958</b>	<b>84,467</b>

\*Vlerësimi sipas Moody lidhet me probabilitetin e falimentimit të qeverisë Shqiptare.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR**  
**MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

**5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.2.1 Rreziku i kreditit (vazhdim)**

*Zhvlerësimi (vazhdim)*

**Të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018**

<b>Përcaktimi i humbjes së pritur</b>	<b>Më pak se 365 ditë me vonesë</b>	<b>1 – 2 vite me vonesë</b>	<b>Mbi 2 vite me vonesë</b>
Balancat e papaguara në datën e raportimit	382,358	16,911	127,367
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	0.08%	0.17%	74.07%
Provigjoni i humbjes së pritshme të kreditit	290	28	94,345

**Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)**

<b>Përcaktimi i humbjes së pritur</b>	<b>Më pak se 365 ditë me vonesë</b>	<b>1 – 2 vite me vonesë</b>	<b>Mbi 2 vite me vonesë</b>
Balancat e papaguara në datën e raportimit	357,807	1,205	149,038
Norma e humbjes së pritshme të kreditit	0.08%	0.17%	74.07%
Provigjoni i humbjes së pritshme të kreditit	272	2	110,398

Tabela e mëposhtme jep informacion në lidhje me ekspozimin bruto ndaj rrezikut të kredisë dhe humbjet nga zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017:

	<b>Vlera kontabël bruto</b>	<b>Zbritje për humbjet nga zhvlerësimi</b>	<b>Vlera kontabël neto</b>
<b>31 dhjetor 2018</b>			
Familjet	40,897,578	(39,718,440)	1,179,138
Të arkëtueshme nga OSHEE	52,446,100	(86,569)	52,359,531
Të arkëtueshme nga OST	4,420,069	(7,293)	4,412,776
Të arkëtueshme nga taksa e akcizës	1,156,226	-	1,156,226
Të arkëtueshme në lidhje me SHKEE	862,121	(862,121)	-
Të arkëtueshme lidhur me rastin Jacobsen	168,173	(168,173)	-
Të arkëtueshme të tjera	2,691,187	(382,934)	2,308,253
<b>Totali</b>	<b>102,641,455</b>	<b>(41,225,530)</b>	<b>61,415,924</b>
	<b>Vlera kontabël bruto</b>	<b>Zbritje për humbjet nga zhvlerësimi</b>	<b>Vlera kontabël neto</b>
<b>31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>			
Familjet	41,109,172	(39,734,501)	1,374,671
Të arkëtueshme nga OSHEE	50,187,145	(82,809)	50,104,336
Të arkëtueshme nga OST	1,004,812	(1,658)	1,003,154
Të arkëtueshme nga taksa e akcizës	1,156,226	-	1,156,226
Të arkëtueshme në lidhje me SHKEE	862,121	(862,121)	-
Të arkëtueshme lidhur me rastin Jacobsen	168,173	(168,173)	-
Të arkëtueshme të tjera	2,196,520	(384,898)	1,811,622
<b>Totali</b>	<b>96,684,169</b>	<b>(41,234,160)</b>	<b>55,450,009</b>

Grupi përcakton një fond për humbjet nga zhvlerësimi që përfaqëson vlerësimin e tij të humbjeve të ndodhura në portofolin e llogarive.

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

## 5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

### 5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### 5.2.1 Rreziku i kreditit (vazhdim)

*Zhvlerësimi (vazhdim)*

Lëvizjet ne provigjonin për rënien vlerë në lidhje me të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera gjatë vitit ishin si vijon:

	<b>2018</b>	<b>2017 (riparaqitur)</b>
Gjendja më 1 janar	(41,234,160)	(41,047,743)
<i>Humbjet e njohura nga zhvlerësimi:</i>	8,630	(186,417)
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>	<b>41,225,530</b>	<b>(41,234,160)</b>

Shuma prej 41,225,530 mijë Lekë nga zhvlerësimi total i njohur më 31 dhjetor 2018 (2017: 41,234,160 mijë Lekë) lidhet me gjendjen e të arkëtueshmeve nga klientët familjarë për faturat e energjisë elektrike të papaguara që datojnë para dates së ndarjes së KESH nga OSHEE, të cilat Grupi nuk pret t'i mbledhë. Pjesa e mbetur e humbjeve nga zhvlerësimi më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 lidhet me disa të arkëtueshme të mbartura prej një kohe të gjatë, me asnjë tregues për t'u mbledhur,

*Politika e fshirjes*

Grupi fshin balancat e të arkëtueshmeve (dhe çdo fond lidhur me humbje nga zhvlerësimi) kur Drejtimi vendos se të arkëtueshmet janë të pambledhshme. Ky vendim arrihet pasi konsiderohen informacione të tilla si masat domethënëse që janë ndërmarrë për rikuperimin e shumës, dhe se nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e balancave të papaguara. Vendimi i Drejtimit konfirmohet nga Bordi Drejtues i Grupit gjatë rishikimit dhe aprovimit të shifrave finale të pasqyrave financiare.

#### 5.2.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku nga humbja që rezultojnë prej ndryshimeve në çmimet e tregut të brendshëm (çmimi për shitjen e energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit ekspozohet Grupi në një moment të caktuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për çmimet e ardhshme ose ndryshimet në normat e tregut dhe përbërjen e aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Grupit.

*Rreziku i kursit të këmbimit*

Rreziku i kursit të këmbimit rrjedh prej faktit që të ardhurat e Grupit dhe pjesa më e madhe e kredive dhe të arkëtueshmeve të shprehura në LEK, ndërsa pjesa më e madhe e huave dhe të pagueshmeve të Grupit janë të shprehur në monedhë të huaj (përfshirë EUR, USD, CHF, YEN dhe KRW). Rreziku është që vlera e flukseve të parasë në monedhë funksionale që lind prej ripagimit të huave dhe interesave respektive do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë domethënëse fitimet e Grupit. Për qëllimin e optimizimit të kostove të financimit, në disa raste, Grupi ka marrë hua fonde në monedhë të huaj, kryesisht në USD, EUR dhe YEN. Tabela më poshtë përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare dhe përmbledh ekspozimin e Grupit ndaj kurseve të këmbimit në datën e raportimit:

	<b>2018</b>			<b>2017 (riparaqitur)</b>		
	<b>Aktivët financiare monetare</b>	<b>Detyrimet financiare monetare</b>	<b>Pozicioni neto</b>	<b>Aktivët financiare monetare</b>	<b>Detyrimet financiare monetare</b>	<b>Pozicioni neto</b>
LEK	59,532,423	28,635,271	<b>30,897,152</b>	55,727,755	41,019,690	<b>14,708,065</b>
EUR	14,627,841	49,633,058	<b>(35,005,217)</b>	9,673,467	36,476,441	<b>(26,802,975)</b>
USD	2,074,037	6,861,238	<b>(4,787,201)</b>	2,120,508	6,699,756	<b>(4,579,248)</b>
YEN	2,535,497	2,569,874	<b>(34,377)</b>	2,397,689	2,414,676	<b>(16,987)</b>
CHF	(209,418)	2,767,016	<b>(2,976,433)</b>	909,588	2,708,752	<b>(1,799,164)</b>
Other	2,499,516	2,269,593	<b>229,923</b>	2,390,191	2,209,009	<b>181,182</b>
<b>Total</b>	<b>81,059,897</b>	<b>92,736,051</b>	<b>(11,676,154)</b>	<b>73,219,197</b>	<b>91,528,325</b>	<b>(18,309,128)</b>



*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

## 5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

### 5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### 5.2.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

*Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)*

Kurset e këmbimit të përdorura për përkthimin e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 janë si vijon:

<i>Në Lek:</i>	2018	2017
EUR	123.42	132.95
USD	107.82	111.10
CHF	109.60	113.94
100 YEN	98	98.74

Menaxhimi i rrezikut të kurseve të këmbimit plotësohet përmes monitorimit të ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit ndaj skenarëve të ndryshëm standarde dhe jo standarde të kurseve të këmbimit. Skenarët standardë që konsiderohen në mënyrë të rregullt përfshijnë një rritje ose rënie paralele në kurset e këmbimit prej 100 pikësh bazë (pb).

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj një rritjeje ose rënieje në vlerën e LEK-ut përkundrejt monedhave të huaja (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike dhe një pozicion financiar të qëndrueshëm) është si vijon:

	2018		2017 (riparaqitur)	
	100 pb rritje	100 pb ulje	100 pb rritje	100 pb ulje
<b>Efekti i parashikuar fitim (humbje)</b>				
EUR	(350,052)	350,052	(268,030)	268,030
USD	(47,872)	47,872	(45,792)	45,792
YEN	(344)	344	(170)	170
CHF	(29,764)	29,764	(17,992)	17,992
KRW	2,299	(2,299)	2,390	(2,390)

*Rreziku i normës së interesit*

Në rrjedhën normale të biznesit Grupi merr hua për të financuar operacionet e tij. Grupi ekspozohet ndaj rrezikut të normave të interesit sepse vlera e drejtë e huave me normë fikse dhe flukset e parasë të lidhura me huatë me norma të ndryshueshme do të variojnë me ndryshimin e normave të interesit. Shënimi 12 detajon normat e interesit mbi huatë e Grupit.

Profili i normave të interesit për instrumentet financiarë të Grupit që mbartin interes i raportuar nga drejtimi i Grupit është si më poshtë:

	2018	2017 (riparaqitur)
<b>I Instrumente me normë interesi fikse</b>		
Të arkëtueshme financiare	14,218,975	12,239,676
Huatë	(46,538,259)	(60,444,334)
<b>Totali i instrumenteve me normë interesi fikse</b>	<b>(32,319,284)</b>	<b>(48,204,658)</b>
<b>Instrumente me normë interesi variable</b>		
Të arkëtueshme financiare	4,387,295	4,734,240
Huatë	(30,488,991)	(19,317,466)
<b>Totali i instrumenteve me normë interesi variable</b>	<b>(26,101,696)</b>	<b>(14,583,226)</b>

Një ndryshim i mundshëm i arsyeshëm prej 100 pikësh në normat e interesit në datën raportuese do të rrisë (ulë) fitimin ose humbjen me shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë supozon se të gjithë variablat, në veçanti normat e kurseve të këmbimit qëndrojnë konstantë.

	2018		2017 (riparaqitur)	
	100 pb rritje	100 pb ulje	100 pb rritje	100 pb ulje
Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	843,337	(690,549)	700,963	(556,417)

## **5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

### **5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

#### **5.2.2 Rreziku i tregut (vazhdim)**

##### *Rreziku i çmimit në tregje të tjera - çmimet e energjisë*

Sipas rregullave të modelit të ri të tregut (shih shënimin 1), KESH ushtron rolin e prodhimit të energjisë elektrike, sipas të cilit Grupi duhet të furnizojë OSHEE me një sasi të caktuar energjie për përmbushjen e nevojave të konsumatorëve tariforë fundorë, me një çmim të dakordësuar midis palëve, subjekt miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“MIE”). Kjo sasi do të përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve të miratuar nga ERE dhe do të përcaktohet bazuar në nivelin e prodhimit mesatar historik të KESH duke supozuar një shfrytëzim racional të kapaciteteve të tij prodhuese. Nëse KESH nuk do të jetë në gjendje të furnizojë sasinë e miratuar për OSHEE, kjo e fundit do ta blejë këtë sasi në tregun e parregulluar dhe KESH do të kompensojë OSHEE për diferencën midis çmimit të rregulluar dhe një çmimi referues treg. Tepricat e prodhimit që tejkalojnë shumën e miratuar për OSHEE do t'i furnizohen OSHEE-së për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes me një çmim referues treg. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, KESH operoi sipas rregullave të mëparshme të modelit të tregut, sipas të cilit, përveç rolit të prodhimit të energjisë, Grupi ushtroi gjithashtu rolin e Furnizuesit Publik me Shumicë (“FPSH”). Në rolin e tij si FPSH, Grupi ishte i detyruar të furnizonte OSHEE me të gjithë sasinë e energjisë së nevojshme për përmbushjen e kërkesave të konsumatorëve tariforë fundorë, me çmime të rregulluara nga ERE. Përveç kësaj, në rolin e tij të FPSH-së, Grupit i kërkohej të blinte energjinë e prodhuar nga prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike nga hidrocentralet me çmime të rregulluara nga ERE. Duke filluar nga korriku 2016, sipas modelit të ri të tregut, roli i FPSH-së iu transferua OSHEE-së.

Zbatimi i çmimeve të rregulluara sjell rritje të rrezikut të çmimit për Grupin. Çmimi i rregulluar (FPSH) i zbatuar ndaj OSHEE nga janari deri në qershor 2016 ishte 3 Lekë për kWh. Nga korriku i vitit 2016, pasi roli i FPSH iu transferua OSHEE, çmimi i rregulluar (i prodhimit) i zbatuar ndaj OSHEE ishte 1,45 Lekë për kWh. I njëjti çmim është miratuar nga ERE për vitin 2017 (shih shënimin 24).

Për periudhën janar – dhjetor 2018, MIE përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të KESH sh,a, ndaj OSHEE sh.a. në masën 1.5 Lek/kWh, me vendimin nr. 3924/1 më 26 dhjetor 2017.

Paqëndrueshmëria klimaterike si dhe rreziku hidrogjik i lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e KESH, veçanërisht me pasigurinë e regjimeve të ardhshme të prodhimit dhe mundësinë e tregtimit të tepricave të energjisë, vështirëson llogaritjen e parashikimit të besueshëm në mbështetje të vendimeve mbi investimet, potencialisht çon në kthime të pritura më të ulëta.

##### *Analiza e ndjeshmërisë*

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, një rritje/(zvogëlim) me 10% i çmimit të energjisë, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen të pandryshuar, do të rriste/(zvogëlonte) të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike me 1,638 milion Lekë (2017: 719 milion Lekë).

#### **5.2.3 Rreziku i likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Grupi është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorimin e burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative që ndodhin në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Nga ana tjetër, Grupi përballlet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e shitjeve me kredi përkundrejt OSSHE. Drejtimi monitoron çdo muaj parashikimet e flukseve të parasë së Grupit. Për më tepër, gjatë 2017 Grupi ka përgatitur një skedul për ristrukturimin e overdrafteve bankare me qëllim optimizimin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj njësive për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet, investimet, zgjatjen e pagesave ndaj kreditorëve, riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve, dhe skedulimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara.

Tabela e mëposhtme tregon detyrimet sipas maturimit kontraktual të mbetur. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse të kontraktuara të skontuara të parasë. Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e raportimit.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR**  
**MË 31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

**5.2 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**5.2.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	Deri në një 1 vit	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
<b>2018</b>				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	15,708,801	-	-	15,708,801
Huatë	47,542,511	14,459,469	15,025,270	77,027,250
<b>Totali</b>	<b>63,251,312</b>	<b>14,459,469</b>	<b>15,025,270</b>	<b>92,736,051</b>

	Deri në një 1 vit	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
<b>2017 (riparaqitur)</b>				
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	11,766,525	-	-	11,766,525
Huatë	57,125,768	13,760,535	8,875,497	79,761,800
<b>Totali</b>	<b>68,892,293</b>	<b>13,760,535</b>	<b>8,875,497</b>	<b>91,528,325</b>

**5.3 Menaxhimi i kapitalit**

Objektivat e Grupit në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Grupit për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësisit të kthyeshmërisë për aksionarin dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit. Në mënyrë që të ruajë apo të rregullojë strukturën e kapitalit, Grupi mund të përcaktojë shumën e dividendëve të paguar aksionarit, kthyeshmërinë e kapitalit ndaj aksionarit, të emetojë aksione të reja apo të shesë aktive për të reduktuar borxhin.

Njëlloj me shoqëritë e tjera në industri, Grupi monitoron kapitalin bazuar në raportin e detyrimeve ndaj kapitalit. Ky raport llogaritet si totali i detyrimeve pjesëtuar me kapitalin nën drejtim. Grupi konsideron si total kapitali, kapitalin e paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar. Raporti i borxhit të Grupit më 31 dhjetor 2018 është 1.03 (31 dhjetor 2017: 1.17).

**5. Aktivet financiare – Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)**

**5.4 Ndryshimet në detyrimet që lindin nga aktivitetet financuese**

	1 janar 2018	Disbursime të reja	Pagesa principali	Ndryshime në vlerën e drejtë për disbursimet e reja	Të tjera	31 dhjetor 2018
Huatë afatshkurtra	57,125,768	1,303,163	(4,608,501)	(5,818,319)	(459,599)	47,542,512
Huatë afatgjata	22,636,032	14,334,798	-	(6,842,901)	(643,191)	29,484,738
<b>Totali</b>	<b>79,761,800</b>	<b>15,637,961</b>	<b>(4,608,501)</b>	<b>(12,661,220)</b>	<b>(1,102,790)</b>	<b>77,027,250</b>

Kolona “Të tjera” përfshin efektin e riklasifikimit të pjesës afatgjatë të huave me interes në afatshkurtra për shkak të kalimit të kohës, efektit të kursit të këmbimit të balancave të papaguara në fund të periudhës raportuese dhe efektin e interesit të përlllogaritur, por të pa paguar mbi huatë dhe detyrimet me interes. Grupi klasifikon interesin e paguar si fluks monetar nga aktivitetet operative.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2018**

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ka shprehjet ndryshe)

**6. Aktivet afatgjata materiale**

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Pajisje zyre dhe pajisje informatike	Ndërtim në process	Totali
<i>Kosto historike ose vlerë tregu</i>							
<b>Më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>1,338,185</b>	<b>88,155,167</b>	<b>49,343,718</b>	<b>298,893</b>	<b>194,112</b>	<b>6,154,541</b>	<b>145,484,616</b>
Shtesa	56,653	1,549,795	2,114,090	127,446	193,996	4,102,799	8,144,779
Pakësime	-	(118)	(1,358,667)	(57,027)	(29,834)	(2,154,940)	(3,600,586)
Transferime	-	-	12,385	-	-	(239,980)	(227,595)
<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>1,394,838</b>	<b>89,704,844</b>	<b>50,111,526</b>	<b>369,312</b>	<b>358,274</b>	<b>7,862,420</b>	<b>149,801,214</b>
Shtesa	261,905	1,901,176	-	53,968	36,625	4,340,966	6,594,640
Pakësime	-	-	(2,613,503)	-	-	-	(2,613,503)
Transferime	-	-	-	-	-	(2,163,081)	(2,163,081)
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,656,743</b>	<b>91,606,020</b>	<b>47,498,023</b>	<b>423,280</b>	<b>394,899</b>	<b>10,040,305</b>	<b>151,619,270</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>							
<b>Më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>-</b>	<b>(31,081,914)</b>	<b>(19,147,274)</b>	<b>(82,988)</b>	<b>(66,854)</b>	<b>22,793</b>	<b>(50,356,237)</b>
Amortizimi i vitit	-	(794,594)	(1,102,367)	(41,305)	(58,075)	-	(1,996,341)
Pakësime	-	22	1,289	1,881	1,509	-	4,701
<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>-</b>	<b>(31,876,486)</b>	<b>(20,248,352)</b>	<b>(122,412)</b>	<b>(123,420)</b>	<b>22,793</b>	<b>(52,347,877)</b>
Amortizimi i vitit	-	(924,705)	(1,266,711)	(62,479)	(81,648)	-	(2,335,543)
Pakësime	-	73,518	72,737	(8,150)	8,200	-	146,305
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>(32,727,673)</b>	<b>(21,442,326)</b>	<b>(193,041)</b>	<b>(196,868)</b>	<b>22,793</b>	<b>(54,537,115)</b>
<i>Rënia e vlerës së akumuluar</i>							
<b>Më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>-</b>	<b>(14,071,944)</b>	<b>(7,876,589)</b>	<b>(47,711)</b>	<b>(30,986)</b>	<b>(982,431)</b>	<b>(23,009,661)</b>
Rimarrje	-	6,134,927	3,433,945	20,801	13,510	428,309	10,031,492
Zhvlërësimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>-</b>	<b>(7,937,017)</b>	<b>(4,442,644)</b>	<b>(26,910)</b>	<b>(17,476)</b>	<b>(554,122)</b>	<b>(12,978,169)</b>
Rimarrje	-	57,798	32,352	196	126	4,036	94,508
Zhvlërësimi i vitit	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>(7,879,219)</b>	<b>(4,410,292)</b>	<b>(26,714)</b>	<b>(17,350)</b>	<b>(550,086)</b>	<b>(12,883,661)</b>
<i>Vlera kontabël neto</i>							
<b>Më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>1,338,185</b>	<b>43,001,309</b>	<b>22,319,855</b>	<b>168,194</b>	<b>96,272</b>	<b>5,194,903</b>	<b>72,118,718</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>1,394,838</b>	<b>49,891,341</b>	<b>25,420,530</b>	<b>219,990</b>	<b>217,378</b>	<b>7,331,091</b>	<b>84,475,168</b>
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,656,743</b>	<b>50,999,128</b>	<b>21,645,405</b>	<b>203,525</b>	<b>180,681</b>	<b>9,513,012</b>	<b>84,198,494</b>

Nëse do të ishte përdorur modeli i kostos, vlera kontabël neto që përfaqëson koston e supozuar si pasojë e tranzicionit në SNRF të aktiveve afatgjatë materiale më 31 dhjetor 2018 dhe do të ishte 49,576 milionë Lekë (2017: 43,713 milionë Lekë). Shumat e rivlerësuar përfshijnë një sifit rivlerësimi i cili nuk mund t'i shpërndahet aksonarit. Transferimet kryesisht janë ndërtime në proces të përfunduara gjatë vitit dhe të transferuara në aktive të disponueshme për përdorim.

## 6. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

### (i) Matja e vlerës së drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Në 2015, Grupi ka rivlerësuar vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale duke rezultuar me një rritje neto prej 12,460,994 mijë Lekë, e përbërë nga një rritje e rezervës së rivlerësimit me 12,774,034 mijë Lekë dhe rënie vlere nga rivlerësimi prej 313,040 mijë Lekë e njohur si humbje nga zhvlerësimi në fitimim ose humbje.

Aktivët afatgjata të TEC Vlorë me një vlerë kontabël më 31 dhjetor 2018 prej 8,937,979 mijë Lekë (2017: 9,522,276 mijë Lekë), nuk ishin pjesë e rivlerësimit dhe nuk u rivlerësuan gjatë 2015.

Vlera e drejtë e aktive afatgjata materiale u përcaktua nga një grup me gjashtë ekspert te jashtëm të caktuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Grupi i ekspertëve përbëhet nga tre vlerësues të certifikuar të pasurive të paluajtshëm dhe tre kontabilist të miratuar. Raporti daton më 25 shkurt 2016, ndërsa data efektive e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale të Grupit është 1 janar 2015. Rivlerësimi është kryer në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Vlerësimit.

### *Niveli 3 i vlerës së drejtë*

Vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të Grupit kategorizohen në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Të dhënat e rëndësishme dhe supozimet e përdorur zhvillohen me bashkëpunimin e ngushtë të drejtimit.

Tabela më poshtë tregon teknikat e vlerësimit në matjen e vlerës së drejtë të aktiveve afatgjata materiale si edhe të dhënat e rëndësishme të pa-vëzhgueshme të përdorur.

<b>Aktivët</b>	<b>Teknika e vlerësimit</b>	<b>Të dhënat e rëndësishme të pavëzhgueshme</b>
Ndërtesa	Kosto e zëvendësimit e amortizuar: Nuk ka evidencë tregu apo të krahasueshme për këto prona.	Çmimet e tregut janë modifikuar për të reflektuar sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Niveli i transaksioneve të aktivitetit të tregut është i ulët ose çmimi për një pronë identike është i vështirë të sigurohet.</li> <li>Kushtet specifike të çdo prone (ndërtimi, pozicioni, instalimet energjitike).</li> </ul>
Makineri dhe pajisje	Kosto e zëvendësimit e amortizuar: Nuk ka evidencë tregu apo të krahasueshme për këto aktive.	Përcaktimi i vlerës së drejtë është shumë subjektiv, për shkak të sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Çmimi për një aktiv identik është i vështirë të sigurohet për shkak të mungesës së aktivitetit të tregut dhe natyrës specifike të aktivitetit.</li> <li>Kushtet specifike të çdo aktivi, përfshirë ciklin e projektuar të jetës, i cili mund të ndryshojë si rezultat i ndryshimeve në treg.</li> </ul> <p>Ndryshimet në supozimet e kryera për këto të dhëna të pavëzhgueshme, nëse ka, mund të sjellin korrigjime të rëndësishme në vitin e ardhshëm financiar.</p>
Toka, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe informatike	Krahasimi i drejtpërdrejtë	Çmimet e tregut janë modifikuar për të pasqyruar sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Niveli i transaksioneve të aktivitetit të tregut është i ulët ose çmimi për një aktiv identik është i vështirë të sigurohet.</li> </ul> <p>Kushtet specifike të çdo aktivi.</p>

## **6. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)**

### **(ii) Testi i zhvlerësimit**

*Testi i zhvlerësimit më 31 dhjetor 2015 deri me 31 dhjetor 2018*

Siç përshkruhet më lart, vlera e drejtë e pjesës më të madhe të aktiveve afatgjata materiale të Grupit, për shkak të natyrës së tyre specifike, është përcaktuar bazuar në metodën e “Kostos së Re të Amortizuar të Zëvendësimit, pjesë e Qasjes së Kostos. Për këtë qëllim, Standardi Ndërkombëtare i Raportimit Financiar 36 (“SNK 36”) thekson se “një entitet duhet të vlerësojë në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë indikacion nëse aktivet janë zhvlerësuar. Nëse një indikacion i tillë ekziston, entiteti duke të përllogarisë shumën e rikuperueshme të aktiveve”.

Shuma e rikuperueshme është vlera me e lartë midis Vlerës në Përdorim dhe Vlerës së Drejtë minus Kostot e Shitjes. Vlera e Drejtë bazohet në Qasjen e të Ardhurave, specifiku në metodën e Mjeteve Monetare të Skontuara, ndërsa Vlerës së Drejtë minus Kostot e Shitjes bazohet si në Qasjen e të Ardhurave ashtu edhe në Qasjen e Tregut.

Referuar indikacioneve të SNK 36, Grupi realizoi testin e zhvlerësimit për aktivet afatgjata materiale që ishin subjekt rivlerësimi dhe vlerësoi shumën e tyre të rikuperueshme më 1 janar 2019. Aktivet afatgjata materiale të TEC Vlorë nuk u testuan për zhvlerësim në 2018.

Për qëllim të testit të zhvlerësimit, drejtimi ka identifikuar tre Njësi Gjeneruese të Mjeteve Monetare (“CGU”) të pavarura brenda KESH sh.a, Hec Koman, Hec Fierza dhe Hec Vau i Dejës, të cilët gjenerojnë mjete monetare hyrëse në mënyrë tërësisht të pavarur nga njëri-tjetri. Gjithashtu aktiviteti operativ i të tre CGU-ve mbështetet nga KESH Qendër. Prandaj, për arsye të Testit të Zhvlerësimit, KESH Qendër është konsideruar si një njësi kostoje (aktiv kolektiv), e cila menaxhon aktivitetin tregtar të të tre CGU-ve.

Ne rastin konkret, duke marrë në konsiderat specifikat e aktivitetit operativ të shoqërisë drejtimi ka gjykuar që shumën e rikuperueshme të përfaqësohet vetëm nga Vlera në Përdorim në këtë Test Zhvlerësimi.

Në vazhdim të analizës së testit të zhvlerësimit, Vlera në Përdorim përllogaritet duke u bazuar në flukset e ardhshme monetare të skontuara, që do të gjenerohen nga përdorimi i vazhdueshëm i CGU-ve.

Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e Vlerës në Përdorim janë si më poshtë:

- Vlerësimi i flukseve monetare të skontuara bazohet në një model skontimi me tre faza, i cili përfshin (i) një periudhë specifike të projektuar prej 5 vitesh, (ii) një periudhë ekstrapolimi 4 vjeçare me qëllim reflektimin e implementimit të modelit të tregut dhe (iii) llogaritjen e vlerës terminale të shoqërisë, bazuar në kapitalizimin e flukseve monetare të periudhës terminale.
- Gjenerimi i pritshëm i energjisë është llogaritur duke marrë në konsideratë mesataren historike të prodhimit të 28 viteve të fundit (1991-2018) e cila barazon shumën 4.3 TWh/vit, duke supozuar se do të qëndrojë konstante gjatë periudhës së projektuar. Për më tepër, prodhimi i pritshëm i energjisë është rregulluar për humbjet në transmetim (rreth 3% e energjisë totale të gjeneruar), të cilat gjithashtu janë llogaritur në bazë të të dhënave historike.
- Bazuar në ligjet dhe rregulloret aktuale si dhe duke marrë parasysh implementimin e modelit të ri të tregut (VKM nr. 519, datë 13.07.2016), energjia totale e gjeneruar nga KESH sh.a është supozuar të shitet pjesërisht në tregun e rregulluar dhe pjesërisht në atë të parregulluar (të lirë).
  - Nga viti 2016 deri në 2021 pritet që shitjet të bazohen në modelin aktual të tregut, ku KESH detyrohet t'i shesë FSHU (OSHEE) 3.95 TWh në vit.
  - Vitet 2021-2024 konsiderohen si periudhë tranzicioni me fillimin e aplikimit të modelit të ri të tregut, ku detyrimi i KESH ndaj FSHU (OSHEE) pritet të ulet gradualisht deri në 2.9 TWh.
  - Nga viti 2025 e në vazhdim parashikohet që ky detyrim të ngelet i pandryshuar.
- Tarifa që aplikohet për energjinë e shitur në tregun e rregulluar aktualisht vendoset nga autoritetet përkatëse qeveritare dhe supozohet të reflektojë vetëm normën e inflacionit në Shqipëri. Çmimi i energjisë së shitur në tregun e parregulluar bazohet në çmimin mesatar të HUPX dhe supozohet të reflektojë vetëm normën e inflacionit në Eurozonë dhe kursin e këmbimit Lek/Euro.

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

## 6. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

### (ii) Testi i zhvlerësimit (vazhdim)

- Investimet kapitale të parashikuara për secilën CGU janë bazuar në planin e investimit të Shoqërisë, marrë nga Programi Ekonomik Financiar, i cili më pas është rregulluar për të përjashtuar çdo investim që nuk lidhet drejtpërsëdrejti me aktivet nën shqyrtim si dhe çdo investim me natyrë shpenzimi dhe më pas janë normalizuar për të reflektuar trendin historik të realizueshmërisë.
- Shpenzimet operative të parashikuara për secilën CGU bazohen në planin e investimeve të Shoqërisë, marrë nga Programi Ekonomik Financiar dhe për shkak të natyrës së tyre fikse, pritet të reflektojnë një trend të qëndrueshëm rritës, duke reflektuar vetëm normën e inflacionit.
- Kapitali Qarkullues i aplikuar bazohet në të dhënat historike të Shoqërisë, të cilat më vonë janë rregulluar për të përjashtuar çdo efekt që nuk lidhet drejtpërsëdrejti me aktivitetin normal të shoqërisë.
- Norma e Skontimit (WACC) është llogaritur duke u bazuar në koston e kapitalit dhe koston e borxhit të Shoqërisë, përfshirë ekzaminimin e rreziqeve të industrisë, rreziqeve financiare dhe specifike të shoqërisë, që më pas është përdorur për të skontuar flukset monetare.
- Shuma e flukseve monetare të skontuara është rregulluar më pas duke u pastruar nga balanca e kapitalit qarkullues në çdo periudhë të raportuar, me qëllim identifikimin e Vlerës në Përdorim lidhur me aktivet afatgjata materiale të secilës CGU.

Supozimet kryesore të testit të zhvlerësimit

		<b>Fierza</b>	<b>Koman</b>	<b>Vau i Dejës</b>
Mesatarja e ponderuar e rritjes vjetore të EBITDA (mesatarja e projektimit të 9 viteve)	%	9.5%	9.4%	9.9%
Norma e skontimit (WACC)	%	10.1%	10.1%	10.1%
Norma terminale e rritjes	%	2.0%	2.0%	2.0%
Fluksi monetar në periudhën terminale		<b>3,140,951</b>	<b>4,697,133</b>	<b>2,099,578</b>

### (iii) Garancitë

Nuk ka aktive afatgjata materiale të lëna si kolateral më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017.

### (iv) Ndërtime në rproces

Ndërtimet në proces përfaqësojnë ndërtimet ende të papërfunduara të aktiveve për mbrojtjen e objekteve hidroelektrike.

## 7. Aktivet financiare të arkëtueshme

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
<b>Të arkëtueshme afatgjata</b>		<b>(riparaqitur)</b>
Hua ndaj palëve të treta	7,499,997	7,161,523
Hua ndaj punonjësve	10,307	10,308
Provizjon për zhvlerësim	(31,172)	(28,229)
	<b>7,479,132</b>	<b>7,143,602</b>
<b>Të arkëtueshme afatshkurtra</b>		
Hua ndaj palëve të treta	11,126,730	9,829,9076
Hua ndaj punonjësve	408	408
	<b>11,127,138</b>	<b>9,830,314</b>
<b>Totali</b>	<b>18,606,270</b>	<b>16,973,916</b>

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**7. Aktivet financiare të arkëtueshme (vazhdim)**

**Lëvizja e fondit të provigjonit për të aktivet financiare të arkëtueshme**

	2018	2017 (riparaqitur)
<b>Balanca hapëse më 1 janar</b>	<b>(28,229)</b>	-
Shtesa në huatë ndaj palëve të treta (Rimarrje) / shtesa në huatë ndaj punonjësve (Rimarrje) / shtesa në fondin e zhvlerësimit	(3,234) 55 236	(13,195) (14,414) (620)
<b>Balanca mbyllëse më 31 dhjetor</b>	<b>(31,172)</b>	<b>(28,229)</b>

**Huatë ndaj palëve të treta**

**Më 31 dhjetor 2018**

	Shuma bruto	Pagesa	Disbursime	Efekti i SNRF 9	ECL	Vlera kontabël
OSHEE	10,616,192	-	2,381,823	(2,711,368)	(16,429)	10,270,218
OST	9,189,787	-	-	(1,037,488)	(14,359)	8,137,940
EPCG	349,975	(118,367)	-	(43,826)	(384)	187,397
<b>Totali</b>	<b>20,155,954</b>	<b>(118,367)</b>	<b>2,381,823</b>	<b>(3,792,683)</b>	<b>(31,172)</b>	<b>18,595,555</b>

**Më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)**

	Shuma bruto	Pagesa	Disbursime	Efekti i SNRF 9	ECL	Vlera kontabël
OSHEE	10,616,192	-	-	(2,249,036)	(13,195)	8,353,961
OST	9,195,637	(5,850)	-	(880,125)	(14,414)	8,295,248
EPCG	475,970	(125,995)	-	(35,365)	(620)	313,989
<b>Totali</b>	<b>20,287,799</b>	<b>(131,845)</b>	-	<b>(3,164,525)</b>	<b>(28,229)</b>	<b>16,963,199</b>

Huatë ndaj palëve të treta paraqesin fonde të huazuar nga Grupi nga institucione të ndryshme dhe nën-huazuar shoqërive të mëposhtme gjatë ndarjes së entiteteve

Huatë ndaj OST dhe OSHEE janë nën-huazuar si rezultat i ndarjes së këtyre entiteteve nga KESH dhe kanë maturitete dhe norma mesatare nominale interesi të cilat janë përcaktuar bazuar në marrëveshjet origjinale me huadhënësit (Shënimi 12); dhe

Elektroprivreda Crne Gore AD Nikšić (“EPCG”) në shumën 187,397 mijë Lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 313,645 mijë Lekë), nën kushtet e projektit “Linja e transmetimit Tiranë-Podgoricë. Huaja mbart interes me një normë interesi 0.75% në vit për Pjesën I, EURIBOR+ 0.65% në vit për Pjesën II dhe një normë interesi fikse që të barazojë kostot efektive të financimit të KfW-së në tregun kapital të Euro-s për letrat me vlerë plus shtesën prej 0.65% në vit. Pas disbursimit total të Pjesës II, KESH ka mundësi të kërkojë për periudhën e mbetur një ndryshim nga norma e interesit të ndryshueshëm në një normë fikse interesi. Më 31 dhjetor 2018 Pjesa II nuk ka qënë plotësisht e disbursuar.

**8. Inventarët**

	2018	2017 (riparaqitur)
Lëndë të para dhe materiale	1,444,335	1,403,481
Lëndë djegëse	1,127,710	1,117,557
Provigjon për inventar jashtë përdorimi	(303,334)	(296,724)
Zhvlerësim i naftës TEC Vlorë	(253,770)	-
<b>Totali</b>	<b>2,014,941</b>	<b>2,224,314</b>



**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**8. Inventarët (vazhdim)**

Grupi ka performuar një analizë vjetërsie të inventarit të tij për të identifikuar inventarin me ritme të ngadalta lëvizjeje dhe për të provigjonuar inventarin jashtë përdorimi. Lëvizja e provigjonit për inventarin jashtë përdorimi prezantohet si mëposhtë:

**Provigjon për inventar jashtë përdorimi**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Gjendja hapëse më 1 janar	(296,724)	(293,165)
Provigjon i periudhës	(6,610)	(3,559)
<b>Gjendja mbyllëse më 31 dhjetor</b>	<b>(303,334)</b>	<b>(296,724)</b>

Në dhjetor 2018 Grupi bëri një vlerësim në lidhje me sasinë dhe cilësinë e naftës së mbajtur në TEC Vlorë. Në vijim të vlerësimit, në mënyrë që të përcaktonte çmimin e tregut, Drejtimi nisi një procedure tenderimi në prill 2019 duke ftuar shtatë pjesëmarrës të tregut për të bërë një ofertë për çmimin e inventarit të naftës të mbajtur në TEC Vlorë. Duke marrë në konsideratë mesataren e tre çmimeve të ofruara, çmimi i tregut për inventarin e naftës së mbajtur në TEC Vlorë rezultoi 105.3 Lek/litër.

**9. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Të arkëtueshme tregtare	97,763,748	92,301,129
Të arkëtueshme të tjera	4,877,706	4,383,039
	<b>102,641,454</b>	<b>96,684,169</b>
Provigjoni për zhvlerësim	(41,225,530)	(41,234,160)
	<b>61,415,924</b>	<b>55,450,008</b>

**Lëvizjet e fondit të zhvlerësimit**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Balanca hapëse më 1 janar	(41,234,160)	(41,047,743)
Rimarrje / (Shtesa)	8,630	(186,417)
Balanca mbyllëse më 31 dhjetor	<b>(41,225,530)</b>	<b>(41,234,160)</b>

Informacioni në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të tregut dhe kredisë, dhe provigjoneve për rënie në vlerë është përfshirë në Shënimin 5.2.1.

Gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2018 Grupi ka njohur rimarrje prej 8,630 mijë Lekë nga fondi i provigjonet për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, ndryshe nga 2017 ku Grupi njohu fond shtesë për provigjonin prej 186,417 mijë Lekë në lidhje me balancat jo të rekuperueshme (Shënimi 5.2.1). Të gjitha të arkëtueshmet e Grupit janë vendosur si kolateral për huatë e marra nga bankat.

Llogaritë e arkëtueshme janë të detajuar si në vijim:

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

**9. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera (vazhdim)**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
<b>Të arkëtueshme tregtare</b>		
Familjarë	40,877,579	41,109,172
OSHEE	52,466,100	50,187,145
OST	4,420,069	1,004,812
<b>Totali i të arkëtueshmeve, bruto</b>	<b>97,763,748</b>	<b>92,301,129</b>
Provizjon për zhvlerësim	(40,842,596)	(40,849,262)
<b>Totali i të arkëtueshmeve, neto</b>	<b>56,921,152</b>	<b>51,451,867</b>
<b>Të tjera të arkëtueshme</b>		
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike (“SHKEE”)	862,121	862,121
Autoritetet Tatimore – Të tjera	1,156,226	1,156,226
Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	168,173	168,173
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	37,985	37,862
Llogari të tjera të arkëtueshme	2,653,202	2,158,658
<b>Totali i të tjera të arkëtueshme, bruto</b>	<b>4,877,707</b>	<b>4,383,040</b>
Provizjon për zhvlerësim	(382,934)	(384,899)
<b>Totali i të tjera të arkëtueshme, neto</b>	<b>4,494,773</b>	<b>3,998,141</b>
<b>Totali i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera</b>	<b>61,415,925</b>	<b>55,450,008</b>

Më 10 prill 2018, KESH dhe OSHEE dakordësuan një marrëveshje për njohjen e detyrimeve nga OSHEE dhe pagesës së tyre në këste vjetore. Dukeqënëse të dyja entitetet janë në pronësi shtetërore, dhe dukeqënëse mbyllja e balancave në fjalë ka qënë subjekt e një mosmarrëveshje te gjate të iniciuar nga OSHEE, e cila daton që nga privatizimi i saj në vitin 2009, kjo marrëveshje përbën një indikator të rëndësishëm se këto balanca të arkëtueshme do të mbyllen nga OSHEE duke ju përmbajtur skedulit të përcaktuar në marrëveshje.

Llogari të tjera të arkëtueshme përfshin zëra si Tatim Fitimi për tu kthyer nga Administrata Tatimore (i trashëguar që në periudhën e ndarjes me OSHEE), të arkëtueshme nga debitorë të tjerë, si dhe axhustimet për vlerën e drejtë të huave.

**10. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Mjete monetare në bankë	1,038,201	796,424
Mjete monetare në arkë	927	359
<b>Cash and cash equivalents</b>	<b>1,039,128</b>	<b>796,783</b>
Rënia në vlerë sipas SNRF 9	(1,426)	(1,510)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë me to në pasqyrën e pozicionit financiar</b>	<b>1,037,702</b>	<b>795,273</b>
Rënia në vlerë sipas SNRF 9	1,426	1,510
Overdrafte bankare	(17,467,808)	(33,914,199)
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë me to në pasqyrën e flukseve monetare</b>	<b>(16,428,680)</b>	<b>(33,117,416)</b>

Më 31 dhjetor 2018 nuk ka asnjë kufizim mbi llogaritë bankare të Grupit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, siç janë llogaritë rrjedhëse, të cilat klasifikohen si aktive financiare të matura me koston e amortizuar, kanë qënë subjekt i Qasjes së Përgjithshme. Megjithatë, për shkak se llogaritë rrjedhëse janë në kërkesë, humbjet e pritshme 12-mujore dhe përgjatë gjithë jetës janë të njëjta.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**10. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to (vazhdim)**

Rreziku i kreditit i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to është i kufizuar sepse palët e tjera janë banka me vlerësime të larta, të përcaktuara nga agjencitë ndërkombëtare të kreditit.

<b>31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017</b>	<b>Monedha</b>	<b>Vlerësimi i Moody's</b>
American Bank of Investment ("ABI")	Lek	A1
Banka Kombëtare Tregtare ("BKT")	Lek	Ba2
Credins Bank*	Lek	B1
OTP Bank Albania	Lek	Baa3
Intesa SanPaolo	Lek	Baa3
Raiffeisen Bank Albania	Lek	A2
Tirana Bank	Lek	B2
Alpha Bank	Lek	B2
Union Bank	Lek	B2

Për përcaktimi e Probabilitetit të Falimintimit për bankat e nivelit të dytë, është marrë vlerësimi që Moody's ka dhënë respektivisht për shtetet e origjinës së bankave.

**11. Kapitali**

**11.1 Kapitali aksionar**

Numri total i aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2018 ishte 20,162,799 aksione (2017: 20,174,222 aksione) me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

Regjistrimi i kapitalit të paregjistruar është bazuar në vendimet e aksionarëve detajuar si më poshtë:

	<b>Numër vendimi</b>	<b>Data e vendimit</b>	<b>Data e regjistrimit</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Kapitali i paregjistruar</b>
<b>Më 1 janar 2015</b>				<b>20,040,097</b>	<b>(4,000)</b>
Shtesë kapitali	544/1	11-Shk-15	23-Mar-15	117,012	-
Shtesë kapitali	2549/1	16-Pri-15	8-Maj-15	17,113	-
<b>Më 31 dhjetor 2015</b>				<b>20,174,222</b>	<b>(4,000)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>				<b>20,174,222</b>	<b>(4,000)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>				<b>20,174,222</b>	<b>(4,000)</b>
Zvogëlime kapitali	7606/1	29-Maj-18	16-Kor-18	(11,423)	-
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>				<b>20,162,799</b>	<b>(4,000)</b>

Rritja e kapitalit gjatë 2015 konsiston në kontribute në natyrë në aktive afatgjata materiale. Në korrik 2018 Grupi zvogëloi kapitalin aksionar me 11,423 mijë Lekë, që korrespondon me vlerën e aktiveve të Bahskisë së Vaut të Dejës.

**11.2 Dividendët**

Në përputhje me Ligjin nr. 9901, datuar më 14 prill 2008, Ministria (pronari) aprovon pasqyrat financiare të konsoliduara. Asnjë dividend nuk u shpërnda në 2017 dhe 2016 për shkak se Grupi ka rezultuar me humbje të akumuluar për sejcilin vit respektivisht.

**11.3 Rezervat ligjore**

Rezervat ligjore në shumën 2,643,824 mijë Lekë më dhjetor 2018 (2017: 2,657,219 mijë Lekë) përfaqësojnë përvetësimin e një pjese të fitimeve të mbartura në përputhje me Ligjin nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" datë 14 prill 2008, i cili kërkon që të paktën 5% e fitimit, por jo më shumë se 10% e kapitalit të nënshkruar të mbahet si rezervë ligjore. Më 31 dhjetor 2018, rezervat ligjore përfaqësojnë 13% të kapitalit të nënshkruar të Grupit (2017: 13%).

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**11. Kapitali (vazhdim)**

**11.4 Rezerva të tjera**

Rezervat e tjera përfshijnë rezervën nga rivlerësimi dhe rezerva të tjera të huave afatgjata me vlerën e drejtë në momentin fillestar si më poshtë:

	<b>Rezerva të tjera</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2017 (riparaqitur)</b>	<b>47,062,539</b>
Transferime të rezervës së rivlerësimit	(1,178,645)
Rregullime të rezervës	10,031,489
<b>Balanca më 31 dhjetor 2017 (riparaqitur)</b>	<b>55,915,384</b>
Transferime të rezervës së rivlerësimit	(1,124,715)
Rregullime të rezervës	99,147
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>54,889,816</b>

Rezervat e rivlerësimit përfaqësojnë tepricën e rivlerësimit që shkaktohet nga vlerësimi i pavarur i aktiveve afatgjata materiale i realizuar më 1 janar 2015 (shiko shënimin 6) duke zbritur çdo shumë që më pas është transferuar në fitimin e mbartur (shiko shënimin 4.e).

**11.4 Rezerva e vlerës së drejtë të huave**

Vlera e drejtë e rezervës së huave në shumën 4,702,728 mijë Lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 5,146,532 mijë Lekë) është krijuar si rezultat i matjes së vlerës së drejtë të huave të Grupit gjatë matjes fillestare në përputhje me IAS 39/ SNRF 9, duke konsideruar që huatë janë marrë në kushte lehtësuese për shkak se qeveria e Shqipërisë shërven si garantor ose ndërmjetës.

**12. Huatë**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
<b>Afatgjata</b>		
Huatë nga bankat	17,339,418	7,169,195
Huatë nga qeveria	12,145,320	15,466,837
	<b>29,484,738</b>	<b>22,636,032</b>
<b>Afatshkurtra</b>		
Huatë nga bankat	34,037,683	47,136,764
Huatë nga qeveria	13,504,829	9,989,004
	<b>47,542,512</b>	<b>57,125,768</b>
<b>Totali</b>	<b>77,027,250</b>	<b>79,761,800</b>

Më 31 dhjetor 2018, huatë në shumën 77,027,250 mijë Lekë (2017: 79,761,800 mijë Lekë), mbartin norma interesi më të ulëta se normat e tregut dhe kanë afate maturimi që luhaten nga 2018 deri në 2044.

Grupi i ka njohur huatë në përputhje me SNRF 9, duke përdorur metodologjinë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe koston e amortizuar gjatë matjes së mëpasshme.

Huatë janë garantuar nga qeveria shqiptare dhe nga të arkëtueshmet e Grupit (referoju Shënimet 7).

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**12. Huatë (vazhdim)**

Normat nominale mesatare e interesit në datën e raportimit janë si më poshtë:

<b>2018</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>CHF</b>	<b>YEN</b>	<b>KRW</b>	<b>Lek</b>
Hua nga bankat	2.99%	1.82%	-	2.45%	2.50%	-
Hua nga qeveria	0.98%	3.99%	-	-	-	0.28%
<b>2017</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>CHF</b>	<b>YEN</b>	<b>KRW</b>	<b>Lek</b>
Hua nga bankat	2.85%	2.44%	-	2.45%	2.50%	3.97%
Hua nga qeveria	0.69%	1.90%	-	-	-	0.18%

*Thyerje të kushtëzimeve financiare të huave*

Disa hua në shumën prej 17,321,615 mijë Lekë (2017: 3,320,618 mijë Lekë) dhe të pagueshme midis 2018 dhe 2031 mbartin kushtëzime financiare që kërkojnë që gjatë periudhës së pagesës së kredisë, Grupi të mbajë raporte financiare të përshtatshme, si më poshtë:

- Raporti i mbulimit të borxhit si një tregues i mbulimit të borxhit (të ardhura neto plus amortizimi në raport me interesat dhe principalin mbi kreditë), dhe
- Raporti i borxhit mbi EBITDA si një tregues i aftësisë së Grupit për të shlyer borxhin e shkaktuar.
- Raporti i EBITDA mbi interesin si një tregues i aftësisë së Grupit për të shlyer interesat.

Gjatë 2018 dhe 2017 Grupi nuk përmbushi kushtëzimet financiare nga huatë e dhëna nga BERZH sin ë vijim:

	<b>2018</b>		<b>2017 (riparaqitur)</b>	
	<b>Kërkohet</b>	<b>Aktuale</b>	<b>Kërkohet</b>	<b>Aktuale</b>
Marrëveshje huaje midis KESH dhe BERZH me numër operacioni. 33833, korrik 2004				
- Raporti i mbulimit të borxhit	min.1.25	0.20	min.1.25	0.07
- Gjendja e huasë sipas IFRS 9 më 31 dhjetor	2,143,779		2,259,292	
Marrëveshje huaje midis KESH dhe BERZH me numër operacioni. 36112, tetor 2006				
- Raporti i mbulimit të borxhit	min.1.25	0.20	min.1.25	0.07
- Borxh mbi EBITDA	mak.5.50	6.02	mak.5.50	18.15
- Gjendja e huasë sipas IFRS 9 më 31 dhjetor	1,123,022		1,061,326	
Marrëveshje huaje midis KESH dhe BERZH me numër operacioni. 48132, korrik 2016				
- EBITDA mbi interes	min. 4.00	5.19	min. 4.00	1.62
- Borxh mbi EBITDA	min. 6.00	6.02	min. 5.00	18.15
- Gjendja e huasë sipas IFRS 9 më 31 dhjetor	14,054,814		-	

Në lidhje me disa marrëveshje huaje, gjatë 2018 dhe 2017 KESH nuk ka ripaguar principal dhe interes në datën e pagimit të tyre (bazuar në skedulën e ripagimit). Për rrjedhojë, vlerat e përdorura në kushtëzimet financiare të mësipërme (p.sh raporti i mbulimit të borxhit) reflekton shumat vjetore të principalit dhe interes në përputhje me matjen e vlerës së drejtë dhe koston së amortizuar sipas SNRF 9. Huatë e marra nga BERZH të cilat nuk kanë përmbushur kushtëzimet financiare janë klasifikuar si hua afatshkurtra ne pasqyrat financiare të 2018, me përgjashtim të kredisë nr. 48132 e cila i plotëson kushtëzimet financiare.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**13. Grante**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
<b>Gjendja më 1 janar</b>	<b>119,618</b>	<b>131,152</b>
Grantet e pranuar gjatë vitit	-	-
Të amortizuar gjatë vitit	(3,885)	(11,534)
<b>Gjendja më 31 dhjetor</b>	<b>115,733</b>	<b>119,618</b>

Grantet lidhen me kostot dhe aktivet dhe mund të jenë direkt nga qeveria (përfitime në të mira) ose nga donatorë për qeverinë shqiptare lidhur me aktivitetet e Grupit. Më 31 dhjetor 2018, nuk ka pasur kushte të paplotësuara apo detyrime të kushtëzuara për t'u shpjeguar.

**14. Të pagueshme tregtare dhe të tjera**

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Të pagueshme tregtare	6,182,008	2,319,424
Tatim fitimi i pagueshëm	2,419,684	1,273,872
Autoritet Tatimore – Detyrim nga kontrollet tatimore	1,913,788	2,226,031
Dividendë të pagueshëm	1,834,700	1,834,700
Autoritet Tatimore – TVSH e pagueshme	238,099	(32,482)
Detyrime në lidhje me çështjen e SHKEE	236,928	236,928
Llogari të pagueshme ndaj personelit	55,901	55,919
Autoritet Tatimore – llogari të tjera të pagueshme	42,547	41,995
Llogari të tjera të pagueshme	2,785,146	3,810,138
<b>Totali</b>	<b>15,708,801</b>	<b>11,766,525</b>

Detyrimet nga kontrollet tatimore me vlerë 1,913,788 mijë Lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 2,226,031 mijë Lekë) përbëhen nga detyrime tatimore, gjoba dhe interesa që rezultojnë nga kontrollet tatimore të viteve të mëparshme.

“Llogari të tjera të pagueshme” përfshin provigjonet për shlyerjen e detyrimeve të mundshme ligjore në shumën 973,554 mijë Lekë më 31 dhjetor 2018 (31.12.2017: 1,475,383). Balanca më e madhe e provigjontit lidhet me Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA) në shumën 269,516 mijë Lekë më 31 dhjetor 2018, bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë për hedhjen poshtë të vendimit nr. 143 të ERE në datën 26 dhjetor 2014 për ndryshimin e çmimit të blerjes së energjisë në retrospektive.

**15. Të ardhurat**

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Energji elektrike	16,184,433	7,194,474
Shërbime të ofruara	192,678	95,414
<b>Totali</b>	<b>16,377,111</b>	<b>7,289,888</b>

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
Energji elektrike shitur OSHEE	5,767,272	4,170,671
Energj. Elektr. Shitur me çmime tregu	4,107,949	569,671
Energji elektrike eksporti	3,957,100	541,645
Shitje/Energji per (Balancim)me OST	839,889	
Shitje energjie per mbul.e humbj. OST	500,429	228,963
Shitje energji per mbulimin e humbjeve OSHEE	1,011,409	92,601
Shitje/Energji per mbulimin e disbalancave OST	385	1,590,923
<b>Totali</b>	<b>16,184,433</b>	<b>7,194,474</b>

Gjatë vitit 2018 të ardhurat u rritën në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me vitin 2017 për shkak të rritjes së lartë të prodhimit për shkak të prurjeve të larta dhe shitjes në tregun e parregulluar.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**15. Të ardhurat (vazhdim)**

Të ardhurat sipas pozicionit gjeografik:

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Albania	12,227,333	6,652,829
Zvicer	1,994,099	338,710
Republika Çeke	1,010,125	12,361
Slloveni	305,626	51,297
Sllovaki	226,368	-
Serbi	208,985	139,277
Bullgari	119,817	-
Kosove	88,204	-
Mal i Zi	3,877	-
<b>Totali</b>	<b><u>16,184,433</u></b>	<b><u>7,194,474</u></b>

Të ardhurat e gjeneruara nga shtetet e tjera lidhen me eksportin e energjisë elektrike në shtetet përkatëse.

**16. Të ardhura të tjera operative**

	<u>2018</u>	<u>2017 (riparaqitur)</u>
Grante	3,864	11,534
Gjoha për vonesat në pagesa	2,217	5,437
Heqje e detyrimeve/gjobave tatimore	-	3,783,144
Të tjera	26,263	97,616
<b>Totali</b>	<b><u>32,344</u></b>	<b><u>3,897,731</u></b>

Heqja e detyrimeve tatimore dhe gjobave në shumën 3,783,144 mijë Lekë është bazuar në vendimet nr. 6400/38, datuar më 24.11.2017 dhe 6400/113, datuar më 30.12.2017, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në vijim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, KESH filloi proceduat për kompensimet nga prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike. Shumat e kompensimeve janë njohur në të ardhurat e tjera në periudhën kur janë faturuar dhe pranuar për pagesë nga prodhuesit e pavarur për shkak se Drejtimi e konsideron këtë moment si virtualisht të sigurt që të ardhurat do të merren.

**17. Energji e blerë**

	<u>2018</u>	<u>2017 (riparaqitur)</u>
Energji e importuar	113,240	1,390,970
Energji e blerë nga tregtarë të licencuar	378,273	1,804,392
Kompensimet për disbalancat	(4,165)	451,659
<b>Totali</b>	<b><u>487,348</u></b>	<b><u>3,647,021</u></b>

Referojuni Shënimit 16 për shpjegimet në lidhje me rënien e energjisë së blerë në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

**18. Shpenzime personeli**

	<u>2018</u>	<u>2017</u>
Shpenzime për paga	656,702	649,550
Shpenzime të tjera	116,338	117,574
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	172,198	181,903
<b>Totali</b>	<b><u>945,238</u></b>	<b><u>949,027</u></b>

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**19. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet sipas kategorive përbëhen si vijon:

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Gjoha dhe penalitete (riparaqitur)	715,425	1,006,355
Prime sigurimesh	182,275	278,888
Shërbime për mirëmbajtje	69,864	77,626
Komisione bankare	188,086	59,855
Shërbime ekspertize	42,540	55,676
Shpenzime dietash për udhëtime pune	28,362	35,973
Shërbime të kontraktuara	14,029	23,449
Shpenzime për shërbime përmbarimore	112,981	11,003
Tatime, taksa dhe të ngjashme	8,791	7,817
Telefon dhe postë	5,799	5,522
Shpenzime të tjera	369,351	202,377
<b>Totali</b>	<b>1,737,503</b>	<b>1,764,541</b>

**20. Shpenzime financiare neto**

	<b>2018</b>	<b>2017 (riparaqitur)</b>
<b>Të ardhura financiare</b>		
Të ardhura interesi	646,958	933,908
Fitim neto nga këmbimi valutor	1,911,783	1,002,959
	<b>2,558,741</b>	<b>1,936,867</b>
<b>Shpenzime financiare</b>		
Shpenzime interesi nga huatë	(2,466,783)	(2,716,756)
	<b>(2,466,783)</b>	<b>(2,716,756)</b>
<b>Shpenzime financiare neto</b>	<b>91,958</b>	<b>(779,889)</b>

**21. Tatimi mbi fitimin**

Grupi e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Në vitin 2018 norma e tatimit mbi fitimin është 15% (2017:15%) e të ardhurave së tatueshme.

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Tatimi mbi fitimin e periudhës	2,987,638	584,781
Kreditim i tatimit mbi fitimin e periudhës	(6,394)	(25,880)
<b>Totali</b>	<b>2,981,244</b>	<b>558,901</b>

Në vijim jepet një rakordim i tatimit mbi fitimin i përlogaritur në bazë të normës së tatimit të aplikueshme ndaj shpenzimit të tatim fitimit:

	<b>Norma</b>	<b>2018</b>	<b>Norma</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
Fitimi para tatimit		<b>10,559,703</b>		<b>1,619,230</b>
Tatimi i përlogaritur me normën 15%	15.0%	1,583,955	15.0%	242,885
Efekt i tatimor i shpenzimeve të pazbritshme	12.2%	1,291,362	16.4%	265,293
Humbje e vitit për të cilën nuk është njohur tatim i shtyrë	1%	105,927	3.1%	50,723
<b>Shpenzimi tatimor</b>	<b>28.2%</b>	<b>2,981,244</b>	<b>34.5%</b>	<b>558,901</b>

Humbjet e akumuluar fiskale të Grupit më 31 dhjetor 2018 janë 2,739,224 mijë Lekë (2017: 3,003,040 mijë Lekë) dhe lidhen respektivisht me humbjet fiskale për filialin TEC Vlorë dhe kompaninë bijë KESH Security. Periudha e mbartjes së humbjes fiskale në përputhje me ligjet në Shqipëri është tre vjet.



## 22. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

<b>Humbjet në fund të periudhës</b>	<b>Data e përfundimit</b>	<b>TEC Vlorë</b>	<b>KESH Security</b>	<b>Kesh sha.</b>
31.12.2017	31.12.2020	321,427	-	-
31.12.2016	31.12.2019	1,156,466	-	-
31.12.2015	31.12.2018	1,156,222	-	-

Grupi nuk ka njohur aktive tatimore të shtyra për humbje tatimore të filialeve, sepse nuk pritet të ketë fitime të ardhshme të tatueshme në dispozicion kundrejt të cilave filialet të mund të përdorin humbjet e mbartura tatimore.

### *Ekspozimet fiskale*

Në përcaktimin e vlerës së tatim aktual dhe të shtyrë Grupi merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse taksa dhe interesa të tjera mund të jenë të detyrueshme. Grupi beson se përlllogaritjet e tij të detyrimeve tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet e hapura fiskale bazuar në vlerësimin prej tij të shumë faktorëve, përfshirë interpretimin e ligjit mbi tatimet dhe eksperiencat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarje dhe supozime dhe mund të përfshijnë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Grupi mund të ndryshojë gjykim nën dritën e informacionit të ri që mundësohet, në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime ndaj detyrimeve tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor gjatë periudhës në të cilën ky përcaktim bëhet.

**KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE SHA - KESH**  
**SHËNIMET SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA PËR VITIN E MBYLLUR MË**  
**31 DHJETOR 2018**

(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)

**23. Palët e lidhura**

Sipas vendimit Nr. 317, datë 27 Prill 2016 të Këshillit të Ministrave, pronësia e Grupit u transferua nga MZHETTS në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë ("MEI") sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MEI) dhe u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 24 maj 2016.

Transaksionet e mëposhtme janë kryer me palët e lidhura:

	<b>2018</b>	<b>2017</b> <b>(riparaqitur)</b>
<i>(a) Shitje shërbimesh</i>		
OSHEE	6,778,044	5,402,612
OST	1,340,703	1,819,887
	<b>8,118,747</b>	<b>7,222,499</b>
<i>Blerje për mallra dhe shërbime</i>		
Lanabregas Sha	-	-
OST	78,142	541,991
Entitete të tjera të kontrolluara nga shteti	5,667	4,003
	<b>83,808</b>	<b>545,994</b>
<i>Subvencione të dhëna</i>		
Dëmshpërblim për përmytjet	224,540	503,729
	<b>224,540</b>	<b>503,729</b>
<i>(d) Kompensim i drejtuesve kryesorë</i>		
Paga dhe shpërblime të tjera afatshkurtra	60,089	44,809
Këshilli Mbikëqyrës	5,603	3,493
	<b>65,692</b>	<b>48,302</b>
<i>(e) Llogari që rrjedhin nga aktiviteti</i>		
Llogari të arkëtueshme nga palët të lidhura:		
OSSHE (Shënimi 9)	52,466,100	50,187,145
OST (Shënimi 9)	4,420,069	1,004,812
Autoritet Tatimore - Të tjera (shënimi 9)	1,156,226	1,156,226
	<b>58,042,395</b>	<b>52,348,183</b>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura:		
Balancat me OSHEE (shënimi 14)	-	-
OST	-	-
Autoritet Tatimore- të pagueshme ndaj kontrolleve tatimore (shënimi 14)	1,913,788	2,226,031
Autoritet Tatimore- TVSH e pagueshme (shënimi 14)	238,099	(32,482)
Autoritet Tatimore- Tatimi mbi fitimin (shënimi 14)	2,419,684	1,273,872
Autoritet Tatimore- të tjera tatime të pagueshme (shënimi 14)	42,547	41,994
	<b>4,614,118</b>	<b>5,388,627</b>
<i>(f) Hua të dhëna ndaj palëve të lidhura</i>		
OSHEE (Shënimi 7)	10,270,205	8,353,962
OST (Shënimi 7)	8,137,940	8,295,248
	<b>18,408,145</b>	<b>16,649,210</b>
<i>(g) Hua të marra nga palët e lidhura</i>		
Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Shënimi 12)	25,650,149	25.455.841
	<b>25,650,149</b>	<b>25.455.841</b>
<i>(h) Divident i pagueshëm</i>		
Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Shënimi 14)	1,834,700	1,834,700
	<b>1,834,700</b>	<b>1,834,700</b>

#### **24. Angazhime dhe detyrime të mundshme**

##### *Angazhime – Hua të padisbursuara*

Më 31 dhjetor 2018, Grupi është përfshirë në marrëveshje huamarrjeje në lidhje me projektet për sigurinë e digave në kaskadën e lumit Drin. Disa nga këto shuma të dakordësuara huaje disbursohen në këste. Shuma totale e kësteve të padisbursuara më 31 dhjetor 2018 është 3,551,923 mijë Lekë (2017: 1,185,738 mijë Lekë)

Në 20 prill 2018, Banka Europiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), në përputhje me paragrafin 9.01 të Kushteve dhe Termave të Përgjithshme të Marrëveshjes së Kredisë dhe Marrëveshjes së Garancisë të ratifikuar me Ligjin nr. 125/2016 "Për Projektin Shqipëria: Plani i Ristrukturimit të KESH", informoi KESH sh.a. për bërjen efektive të kredisë së dhënë në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke filluar nga data e marrjes së informacionit. Bazuar në kushtet e marrëveshjes së mësipërme, paragrafi 2.02 (g), duke e bërë efektive marrëveshjen e njoftuar u disbursua kësti i parë prej 118 milionë Euro. Ky këst mbulon disa nga overdraftet që KESH sh.a ka marrë në bankat tregtare.

Shuma totale e padisbursuar për projektin më 31 dhjetor 2018 është 12,342,000 mijë Lekë.

##### *Detyrime të mundshme*

Në rrjedhën normale të aktivitetit Grupi haset me pretendime dhe mosmarrëveshje ligjore. Më 31 dhjetor 2018, Drejtimi i Grupit gjykoj se në këtë datë pritet të ndodhin humbje materiale në lidhje me çështjet ligjore dhe për rrjedhojë është njohur provigjon në lidhje me këto çështje gjyqësore. (Shënimi 14).

##### *Qiratë operative*

Grupi merr me qira ambjente zyresh dhe magazine të ndryshme, të bazuara në kontrata qiraje operative të cilat nuk mund të anulohen. Kontratat e qirasë kanë kushte, klauzola përshkallëzimi dhe të drejta rinovimi kontrate të ndryshme. Kryesisht Grupi përfshihet në marrëveshje qiramarrjeje njëvjeçare të rinovueshme në vazhë vjetore. Më 31 dhjetor 2018 pagesat minimale të qirave për më pak se një vit janë në shumën 14,029 mijë Lekë (2017: 33,605 mijë Lekë).

#### **25. Ngjarje pas datës së raportimit**

##### *Ligjet dhe rregulloret*

- a) Vendimi i ERE nr. 16, i datës 18 shkurt 2019 për "Shtyrjen e afatit të ekzekutimit të kontratës për energji elektrike mes KESH sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Distributorit të Shërbimeve Universal për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018 dhe kontratës për shitblerjen e tepricave të energjisë elektrike që ndodh si rezultat i kërkesave të klientit që ka përfitim nga Shërbimi Universal me qëllimin e mbulimit të hubmjeve nga rrjeti i transmetimit përgjatë periudhës nga 01.01.2018 deri më 31.12.2018".
- b) Vendimi i ERE nr.25, i datës 28 shkurt 2010 për "Licensimin e KESH sh.a. për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit me energji". KESH sh.a. mund të furnizojë me energji klientë të cilët nuk janë pjesë e planit të rregulluar të çmimeve, bazuar në diagramën e liberalizimit të tregut.
- c) Vendimi i ERE nr. 84, i datës 31 maj 2019 për "Aprovimin e kontratës për sigurinë e shërbimeve balancuese (kapaciteti dhe energjia elektrike balancuese) e sistemit të energjisë për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019 midis OST dhe KESH sh.a."
- d) Arovimi i planit financiar të konsoliduar të Sektorit të Sistemit të Energjisë Elektrike në Shqipëri (Rezoluta e Këshillit të Ministrave, nr. 235, e datës 24 prill 2019).

#### **COVID-19**

Në dhjetor 2019, u shfaq një lloj i ri koronavirusi, COVID-19. Megjithë përpjekjet për të mbajtur virusin të izoluar, brenda disa javësh, virusi u përhap dhe ndikoi në mbylljen e qyteteve dhe bizneseve në mbarë botën. Numri i personave të infektuar u rrit ndjeshëm, përfshirë Shqipërinë. Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit shpallë gjendje pandemie për shkak të urgjencës globale të shkaktuar nga përhapja COVID 19. Përhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet mbeten akoma të panjohura. Për detaje të mëtejshme, referojuni Shënimit 3 "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve".

*(Shumat janë në mijë Lekë, përveç se ku shprehet ndryshe)*

**24. Ngjarje pas datës së raportimit (vazhdim)**

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime kontabël ose informacione shpjeguese në pasqyrat financiare të konsoliduara.